



**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**  
**SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**

**Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit**

**Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe**

**STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË**

**TEZA:**

**FOLKLORI NË RAJONIN E PRILEPIT DHE  
KRUSHEVËS**

**Kandidati:**

**Axhije Saliu**

**Mentor:**

**Dr. doc. Meral Shehabi - Veseli**

**Tetovë, 2021**

## PËRMBAJTJA

MIRËNJOHJE .....	4
Lënda e hulumtimit .....	5
Qëllimet e hulumtimit .....	6
Hipotezat .....	7
Fazat e kërkimit .....	7
Metodologjia e kërkimit .....	8
Rëndësia e punimit .....	9
HYRJA .....	10
Kreu i parë .....	12
A. VENDBANIMET ME POPULLSI SHQIPTARE .....	12
1. Komuna e Prilepit .....	12
2. Komuna e Dollnenit .....	12
1. CËRNILISHTË .....	13
2. DESOVË .....	14
3. GOSTIRASH (GOSTIRAZHNI) .....	15
4. PESHTALEVË (PESHTALEVO) .....	15
5. DEBRESH (DEBRESHTE) .....	16
6. LLAZHAN (LLAZHANI) .....	17
7. ZHITOSHË (ZHITOSHE) .....	17
3. Komuna e Krushevës .....	18
8. JAKRENOVË (JAKRENOVO) .....	18
9. SAZHDOVË (SAZHDEVO) .....	19
10. BELLUSHINË (BELLUSHINO) .....	19
11. BORINË (BORINO) .....	19
12. ALLDANÇE (ALLDANCI) .....	20
13. NEROVË (NEROVO) .....	20
14. PRESILL (PRESILL) .....	21
Kreu i dytë .....	22
KËNGËT E DASHURISË DHE TË DASMËS .....	22

1. KËNGËT E DASHURISË .....	23
2. KËNGË FEJESE.....	30
3. RITET E DASMËS .....	32
KLASIFIKIMI I KËNGËVE .....	46
Kreu i tretë .....	58
NINULLAT .....	58
Kreu i katërt .....	62
LOJRAT POPULLORE.....	62
Kreu i pestë .....	72
OJAT .....	72
PËRFUDNIM .....	79
LITERATURA .....	81

## **MIRËNJOHJE**

Për realizimin e kësaj teze masteri dua të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen për mentoren time Doc. dr. Meral Veseli-Shehabi si edhe antarët e komisionit prof. dr. Mustafa Ibrahimin dhe Doc. dr. Luljeta Adili-Çeliku, të cilët më ndihmuan në mënyrë të pakursyer me profesionalizmin e tyre të lartë akademike. Veçanërisht i falënderohem profesoreshës Meral që pranoi të më drejtoj gjatë gjithë kohës së punimi të masterit, por edhe profesor Mustafës që më ndihmoi në strukturimin e temës. Të dyve u jam mirënjohëse për sugjerimet që më kanë dhënë për çështje të ndryshme dhe mënyrën e këndvështrimit të tyre, literaturën e pasur që më kanë nxitur ta përdor, më kanë siguruar, si dhe shpjegimin e paqartësive e pyetjeve, të cilat më lindën gjatë punimit të temës.

Falemnderoj katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe të Fakultetit të Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit në UEJL, për miratimin e kësaj teze masteri, për ndihmën e pakursyer dhe dashamirësinë ndaj kërkesave tona. Mirënjohje për krejt informatorët të cilët nuk kursyen kohë gjatë intervistave dhe më kanë dhënë ndihmë sa herë i vizitoja. Falemnderim dhe mirënjohje të pakufishme edhe për familjen time, e cila më nxiti dhe më inkurajoi vazhdimisht, duke më krijuar gjithë hapësirat e duhura, për t'ia dalë mbanë kësaj detyre të vështirë.

Për të gjithë faleminderit!

## Lënda e hulumtimit

Meqë me mbledhjen dhe botimin e folklorit shqiptar gjatë shekujve, nuk është marrë asnjë në këtë drejtim kontribut të madh do të japë prof. Dr. Mustafa Ibrahimimi me një varg botimesh nga fusha të ndryshme, në mesin e tyre edhe nga fusha e folklorit. Vëllimi më i njohur i tij ngelet libri “Thesari folklorik shqiptar nga rajoni i pelargonisë, të botuar në vitin 2003. Edhe gjatë periudhës pas këtij viti, profesori Ibrahimimi do të mbledh dhe botojë edhe shumë artikuj nga fusha e folklorit në revistën “Zëri i Pelagonisë”.

Sot, si detyrë na ngelet ta ruajmë me xhelozë këtë trashëgimi, dhe mbi gjurmët e tyre të vazhdojmë edhe më tutje duke ia bërë e afërt popullit dhe gjeneratave të ardhëshme. Por nuk duhet të mendojmë se, ajo që është bërë deri tash, ka marrë fund, përkundrazi ka ngelur edhe shumë të punohet në këtë fushë, sidomos në Maqedoni, pasi një pjesë e këngëve popullore gjëllin në gojën e popullit dhe nuk është mbledhur ende. Pra, duhet të krijohen kushte ku do të jenë të gjitha mundësitë për ta mbledhur në mënyrë më të organizuar e në shkallë më të gjerë folklorin e gjuhës sonë, ku do të duhej të ngjallej hulumtimi shkencor i folklorit.

Lënda e hulumtimit të këtij punimi të magjistraturës do të jetë mbledhja dhe studimi i folklorit në vendbanimet shqiptare të rajonit të Prilepit dhe Krushevës. Në territorin e komunës së Dollnenit, përfshihen: maqedonas, shqiptarë, turq, muslimanë-boshnjak dhe torbeshë. Popullsia shqiptare është e përqëndruar në këta fshatra: **Cërnilishtë, Desovë, Gostirazh, Peshtalevë, Llazhan dhe Debreshtë**. Në pikëpamje etnike, në komunën e Krushevës jetojnë disa nacionalitete. Popullata shqiptare jeton në: **Borinë, Norovë, Aلدance, Jakrenovë, Sazhdevë, Presill dhe Bellushinë**. Më parë shqiptarë ka pasur edhe në fshatrat **Dërnovcë, Pribillcë, Novosellë, Zagoricë, Ivanovcë**, dhe në **Vërboec**.

Punimet e shumta që kemi bërë në këtë lëndë se bashku me profesorin Ibrahimimi gjatë studimeve deridiplomike me shtynë që të mbledh dhe të nxjer në pah diçka më tepër rreth kësaj fushe, duke gjurmuar fshat pas fshati nga këto dy komuna.

## Qëllimet e hulumtimit

“Folklori në rajonin e Prilepit dhe Krushevës” është një fushë, e cila shpreh vlerat dhe origjinalitetin e popullit shqiptarë në rrafshin e Pelagonisë, për këtë arsye duhet të mblidhet materiali dhe studiohet në çdo aspekt, sepse siç thoshte shpesh profesor Ibrahim, me vdekjen e një plaku vdes edhe një pjesë e kulturës së trashëguar.

Si qëllim parësor në studimin tonë të masterit do të jetë mbledhja e thesarit popullor, si: këngët e ndryshme që lidhen me tradita dhe zakonet e ndryshme të fejesës, martesës, dashurisë, ceremonitë e dasmës etj. Edhe pse, mjaft janë mbledhur, prap duhet të mblidhen pasi ato zhduken nga mendja e popullit, sidomos me mbarimin e jetës së një plaku. Pra na duhet edhe shumë që të fitojmë në tërësi të përgjithshme të folklorit tonë. Gjithashtu nuk duhet të harrojmë, se edhe atë material që e kemi vuan nga mangësi të ndryshme, siç janë përshkrimet dialektologjike të gabuara. Krejt kjo mund të përmirësohet, me mbledhjen e saktë të këtij materiali, duke u përqëndruar edhe në disa parime dialektologjike dhe gjuhësore. Mbledhja e materialit folklorik, gjithashtu është një nga detyrat parësore të të gjithë punonjësve intelektual, pasi ky aktivitet kërkon kyçje të një numri më të madh njerëzish.

Në mbledhjen e folklorit duhet të përqëndrohemi në dy fusha kryesore të kërkimit në botën materiale dhe botën shpirtërore. Kjo tezë magjistrature ka për qëllim përmes një hulumtimi t’u përgjigjet shumë pyetjeve.

Disa nga synimet e kësaj teme janë:

- Ku shtrihen shqiptarët e Prilepit dhe Krushevës dhe cili është historiku i tyre?
- Si bëhen dasmat? Cilat janë zakonet dhe ceremonitë e fillimit dhe mbarimit të dasmave?
- Çfarë këngë dashurie janë kënduar?
- Regjistrimi i këngëve që këndohen në ceremoni të ndryshme të dasmës.
- Çfarë zakone përdoren gjatë marrjes dhe mbylljes së nuses?
- Të mblidhen sa më shumë që të jetë e mundur këngë që lidhen me etapat e nuses.
- Të studiohen këngët dhe ceremonisë e dasmës
- Të hulumtohen lojërat popullore dhe prejardhja e tyre.
- Të hulumtohen ojat dhe qëndisjet e vjetra popullore.

## Hipotezat

Çdo studim hulumtues kërkon punë serioze duke u bazuar në fakte reale dhe me prova në terren mirëpo ndodh që vlerësimet të jenë të parëndësishme sepse mund të ndeshen me problemet e vërteta të folklorit shqiptar në rajonin e Prilepit dhe Krushevës, ndaj në këtë studim do të paraqesim këto hipoteza:

1. Folklori në vendbanimet shqiptare të Prilepit dhe Krushevës ende është gjallë duke u zbehur andaj, ajo sa më parë duhet të mblidhet dhe të studiohet në të gjitha komponentët e saja më pas mund të jepen shkallët e vlerësimit.
2. Një hipotezë e rëndësishme është edhe pyetja, *a ekzistojnë ende këngë dhe ceremoni në këto fshatra?* Në shikim të parë, kjo pyetje mund të merret si të tepërt, por po të shikojmë pak më thellë, dasmat sot i bëjnë nëpër restorante dhe vetëm një ditë, por jo 7 ditë sa zgjaste më parë.
3. Vallë a vazhdon të praktikohen ceremonisë para fillimit të dasmave.
4. Të definohen dhe përkufizohen nocionet bazë të lidhura me temën dhe lëmin e hulumtimit.
5. Të theksohet rëndësia dhe roli i temës në këtë tezë magjistrature në shoqërinë bashkëkohore.

## Fazat e kërkimit

### Faza përgatitore

1. Studimi i literaturës.
2. Hartimi i pyetësorëve.
3. Formulimi i platformës studimore “**Folklori në rajonin e Prilepit dhe Krushevës**”

### Faza e mbledhjes të të dhënave

1. Pyetësorët për ekspeditat folklorike.
2. Intervistat e drejtpërdrejta.
3. Materialet folklorike në periodikë të kohës dhe shfrytëzimi i literaturës.
4. Materiale folklorike, ndryshoret siç janë ata të gjinisë, moshës e besimit.

### Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre

1. Përqasja me studime të mëparshme, duke plotësuar analizën për një territor më të gjerë që

përfshin mbi 15 pika të grumbullimit të të dhënave.

2. Analiza e veçorive fonetiko-gramatikore dhe shqyrtimi sociolinguistik i folklorit, duke e parë në vështrim përqasës me punime të mëparshme në këtë fushë.
3. Shqyrtime të thelluara dhe mbështetëse për folklorin
4. Përgjithësime dhe përfundime.

## **Metodologjia e kërkimit**

Metodologjia e kërkimit tim do të bazohet në vëzhgimin për çdo ditë të ligjërit të gjallë të njerëzve dhe shfrytëzimin e të gjitha rasteve e mundësive për të mbledhur lëndën folklorike. P.sh. në bisedat e zakonshme në familje, në qendra pune, në tren e autobus; dasmat e festat tjera, vdekjet e vajtimet etj. Në të gjitha këto raste mund të zbulohen fjalë e shprehje të vlefshme. Duhet pasur parasysh edhe zgjidhjen e bashkëbiseduesit, i cili duhet të jetë vendas dhe të përfaqësoj vërtetë të folmen e krahinës së vet; të jetë i gojës që kuvendojnë lirshëm dhe që kanë shqiptim të rregullt; duhet të zgjidhen nga të gjitha moshat dhe të dy gjinitë, natyrisht sipas fushave. Më të moshuarit zgjidhen për fushat siç janë: kujtime, ngjarje e dukuri të së kaluarës, ndërsa për punët shtëpiake, për gatim gjellësh, për punëdore, zgjidhen gra që janë marrë gjatë kohë me këto punë. Për lodra të ndryshme zgjidhen edhe fëmijë e të rinj etj.

Puna me bashkëbiseduesin mund të bëhet me dy metoda: a) Metoda e bisedës së lirë, për të shtyrë atë të shpreh ndjenjat e mendimet e veta, përshtypjet dhe bindjet që ka. Në fillim me bashkëbiseduesin flasim lirisht për çfarëdo temë, pa mbajtur shënime, e gjallërojmë bisedën dhe e bëjmë të ngrohtë, duke i hequr çdo ngurim e duke i bërë të njohur në këtë mes edhe qëllimin e punës sonë. b) Metoda e pyetjeve dhe e përgjigjeve. Përdoret zakonisht për të mbledhur leksikon konkret, siç janë emrat e sendeve, të mjeteve, të veshjeve, të orendive, të pjesëve të veglave etj. Pyetjet që bëjmë nuk duhet të jetë e tillë që të përmbajë emrin e sendit, këtë emër duhet ta nxjerrim nga bashkëbiseduesi. Megjithatë, përfundime më të mira, mund të sjell gërshetimi i të dyja metodave.



## Rëndësia e punimit

Ky punim “Folklori në rajonin e Prilepit dhe Krushevës” është shumë i rëndësishëm pasi krijimtaria popullore, sidomos folklori paraqet frymëzim shpirtëror të një populli, duke pasqyruar: historinë, mentalitetin, doket, ritet, besimet etj. Kjo krijimtari është e nevojshme për t’iu kundërvënë ideologjisë së huaj, e cila mohon të gjitha vlerat etnike dhe ekzistenciale të një populli, ndërsa me publikimin e folklorit bëhet afirmimi krijues i popullit tonë.

Doket dhe zakonet e shqiptarëve të rrafshit të Pelagonisë, paraqesin një begati të madhe, jo vetëm për kulturën shqiptare dhe identitetin, por edhe mjet për t’iu kundërvënë asimilimit të qenies së tyre.

Këta vendbanime jo vetëm se e kanë ruajtur gjuhën, por edhe doket dhe zakonet e dasmave, që u kushtohet rëndësi të madhe, si në shtëpinë e djalit, ashtu edhe në atë të vajzës. Dasmat dikur bëheshin 7 ditë (prej të martën deri të martën), kurse sot bëhen 1 ditë.

Përmes këtij hulumtimi do të prezantohen historiku i shqiptarëve dhe folklori i tyre. Ky punim magjistrature dhe hulumtimi i tij mund të shoh dritën e botimit, e cila nuk do të jetë e përkushtuar vetëm për studentët apo studiuesit dhe intelektualët e ndryshëm, por edhe për ruajtjen e këtij thesari nga zhdukja e sigurtë.

## HYRJA

Studimet folklorike nga rajoni i Prilepit dhe Krushevës janë të pakta dhe të reja në folkloristikën shqiptare, të cilat dalin me interes për t'u studiuar në ditët tona. Dikur materialet e mbledhura kryesisht për çështje folklorike dhe dialektore, këngët e dasmave dhe bisedat e zhvilluara në odat e burrave, e pse jo edhe në dhomat e grave, me rastin e martesave, sot të na dalin me shumë interes për të parë nivelin e komunikimit të banorëve dhe trevave të ndryshme. I vetmi studiues që ka dhënë kontribut në këtë çështje është prof.dr. Mustafa Ibrahim, i cili është edhe anëtar i komisionit për tezën time të masterit.

Në këtë punim do të trajtojmë të gjitha ceremonisë e dasmës, këngët e dashurisë, parafejese, të dasmës, urimet dhe përshëndetjet në ceremoninë e dasmës nga breza të ndryshëm në të njëjtën trevë gjuhësore, duke synuar e kundruar gjithnjë në gjetjen e dukurive fonetike, morfologjike dhe sintaksore të ndryshme, të cilat në treva të tjera dëgjohen përafërsisht ose edhe krejt ndryshe.

Fshatrat e komunës së Prilepit dhe Krushevës, martesat i bëjnë ndërmjet shqiptarëve kryesisht në mes fshatrave, sepse në qytetet e Prilepit dhe Krushevës nuk kanë mbetur më shqiptarë. Shumica e martesave kryhen në rrethe të caktuara. Kjo mund të bartë me vete edhe mendimin ose shprehjen *"dhe me dhe, fe me fe"*, që do të thotë miku të jetë me doke e zakon të njëjta. Kohëve të fundit, si rezultat i emancipimit të femrës, rregulli i martesës vetëm brenda fshatrave ka filluar të mos përfilllet. Tani, vajzat e Pelagonisë, martohen në vende të ndryshme të Maqedonisës së Veriut, qoftë në fshat apo në qytete si Tetovë, Shkup, Kumanovë etj.

Martesat ndëretnike nuk ekzistojnë. Edhe nëse ndodhin ato mund të jenë ose kanë qenë shumë të rralla dhe janë shumë specifike dhe bëhen pa pëlqimin e familjeve dhe si të tilla nuk përkrahen e miratohen kurrë. Akti që i prin dasmës, pas fejesës, është ndarja e vades. Caktimi i kohës për marrjen e nuses i ka paraprirë përgatitjes për dasmë nga ana e atij që merrte nuse dhe kanagjeçit, nga ana e atij që përcillte vajzën. Prandaj edhe me këtë fjalësit e kësaj treve kanë shkëmbyer urime, si p.sh: *"filani osht forcou"* dhe përgjigja e pritësit është *"po"* ndërsa uruesi uron me shprehjet *"ani për ajr ne t'jet"* e ndonjë nga brezi i ri edhe *"urime"*, etj.

Deri para disa vitesh dasmat zgjasnin tri ditë, ndërsa kohëve të fundit ato janë reduktuar në dy ditë, apo vetëm në një ditë. Më herët ato janë organizuar në shtëpi të prindërve të djalit, kurse në kohët e fundit po organizohen në restorante e lokale përkatëse për dasma.

Një ditë para se të fillonte dasma mblidheshin bijat, (vajzat e martuara, motra, halla të dhëndrit). Ato bëheshin pjesë e punëve përgatitore për dasmë. Rregullonin shtëpinë, dilnin te fqinjët dhe tubonin gjësende që i mungonin shtëpisë që bënte dasmë.

Magjaresha: për përgjegjësinë e gatimit të bukëve, piteve (byrekëve) dhe gjërave tjera caktohej një grua e fqinjëve në rolin e magjareshës. Ajo ishte përgjegjëse, kurse në ndihmë i vinin edhe gra tjera.

Në të kaluarën dasma ka pasur karakter më të gjerë<sup>1</sup> sesa kanagjeqi. Edhe gëzimi ka qenë më i madh. Të ftuarit kanë qenë të të gjitha lidhjeve me familjen e atij që martonte djalë, apo djem<sup>2</sup>.

Dasmat dikur organizoheshin në ambiente të ndara, burrat tuboheshin në oda dhe gratë në shtëpi. Kjo praktikë nuk ndodh më. Por shumica e dasmave organizohen në ambiente të përbashkëta, në shtëpi apo restorante të posaçme për dasma.

Dasmat i përcjell një “program” i pasur duke filluar nga ritet e deri tek muzika dhe llojshmëria e këngëve. Më herët edhe muzika ka qenë e ndarë, tjetër për burra, tjetër për gra. Për burra janë marrë lodraxhitë me curla. Te gratë janë marrë dahiret apo si janë quajtur “*xhypkët*” (romët), të cilat kanë kënduar me def, ndërsa gratë kanë hedhur valle.

Këngët e dasmës janë këngë që kryesisht u japin epitete të mira çiftit martesor, djalit dhe vajzë. Në ato raste ngritet lartë jeta e të rinjve. Ata konsiderohen si “student” edhe atëherë kur ata nuk janë të tillë. Më herët janë kënduar këngë që kanë pasur përmbajtje serioze, por edhe gazmore, kurse kohet e fundit ka hyrë (për fat të keq) edhe stili i ashtuquajtur “*tallava*”, ku përveç ritmit nuk ka asgjë përmbajtjesore.

Fjalët dhe shprehjet në raste martesë janë të ndryshme. Te brezi më i vjetër dëgjohen shprehjet si: Për hajr dasma! ose “*per hajr e me nafakë*” brezi i ri e thotë: *me fat, e u trashëgofshin, ishalla me këmbë të mbarë* (vjen nusja).

Ashtu si në mbarë pjesën veriore të Shqipërisë dhe Kosovë, edhe në fshatrat tona nuk ishte zakon që dhëndëri të ishte pjesë e dasmorëve<sup>3</sup> që do të shkonin te familja e nuses, por kohëve të fundit kjo praktikë ka filluar të ndryshojë, sidomos pas mbarimit të luftës, dhëndëri ka filluar të jetë pjesë e dasmorëve.

---

<sup>1</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, Morava, Tiranë, 2010, f. 60.

<sup>2</sup> Gj. Shkurtaç, *vep. cit.* f. 160.

<sup>3</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *vep. cit.* f. 60.

# Kreu i parë

## A. VENDBANIMET ME POPULLSI SHQIPTARE

Profesor doktor Mustafa Ibrahim, në veprën e tij “Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të rrethit të Prilepit, Krushevës dhe Velesit”, Interlingua, Shkup, 2010, nga faqe15-48 gjerësisht i paraqet vendbanimet me popullsi shqiptare në rajonin e Prilepit dhe Krushevës. Aty jepen edhe të dhëna statistikore për popullsinë, fiset kryesore, mëhallat, etimologjia e fshatit etj. Ne shfrytëzuam këto të dhëna për t’i përfshirë edhe në punimin tonë të masterit, duke falënderuar profesorin jo vetëm për këto të dhëna, por edhe për kontributin e madh që jep për studimet shkencore që lidhen me këtë rajon.

### 1. Komuna e Prilepit

Territori i komunës së Prilepit përfshinë pjesën veriore të Pelagonisë, rrafshnaltën më të madhe në Republikën e Maqedonisë, që kap sipërfaqe prej 1215,5 km<sup>2</sup>. Fushëgropa gjendet në një sipërfaqe mbidetare prej 550-700 metra. Në kuadër të atij regjioni veçohen tri tërësi më të vogla gjeografike: Fusha e Prilepit, një pjesë e Mariovës dhe një pjesë e luginës së Raeçkës. Po ashtu kjo fushë nga të tri anët është e rrethuar me male, të cilët midis veti janë ndarë me gryka mali. Në veri është mali *Dautica* (2087 m), në lindje janë malet *Babuna* (1764 m) dhe *Seleçka* (1472 m), dhe në perëndim është mali *Bushava* (1495 m).<sup>4</sup>

Në kuadër të këtij rajoni, sipas ndarjes së re territoriale u krijuan edhe komunat e: **Dollnenit**, **Krivogashtanit**, **Topollçanit** dhe **Vitolishtes**.

### 2. Komuna e Dollnenit

Territori i komunës së Dollnenit përfshinë pjesën më veriore të Pelagonisë, gjegjësisht të Fushës së Prilepit. Është i rrethuar me disa male, edhe atë, në lindje me **Babunën**, në veri me **Dauticën**, në perëndim me **Bushavën**, dhe në jug kah rrafshina e Fushës së Prilepit. Kufizohet me komunat e Prilepit, Izvorit, Bogomillës, Makedonski Brodit, Krushevës, Zhitoshës dhe Makedonski Brodit. Nëpërmjet kësaj komune kalon edhe rruga rajonale Prilep dhe Makedonski Brod, si dhe linja hekurudhore Veles-Prilep-Manastir. Territori i komunës së Dollnenit përfshinë 389 km<sup>2</sup>, dhe numërohet në

---

<sup>4</sup> Ilija Baçeski, Prilep i okolinata ( prirodno - geografski i socioloski karakteristiki ). Prilep 1976, f.7.

një nga komunat më të mëdha të Republikës. Në kuadër të komunës janë përfshirë 33 vendbanime.

Në territorin e komunës së Dollnenit, jetojnë: maqedonas, shqiptarë, turq, myslimanë-boshnjak dhe torbeshë. Popullsia shqiptare jeton në këto fshatra: **Zhitoshë, Cërnilishtë, Desovë, Gostirazhni, Peshtalevë, Llazhan dhe Debreshtë.**

Sipas përkatësisë nacionale, në 19 vendbanime jeton kryesisht popullsi maqedonase, ndërsa në 14 vendbanime struktura e popullsisë është e përzier. Sipas regjistrimit 1994 komuna e Dollnenit ka pasur: 5.494 maqedonas, 2962 turq, 1613 shqiptarë, 13 serb. Popullsia më kompakte shqiptare në këtë komunë janë në: Zhitoshë, Cërnilishtë, Desovë, Gostirazhni, Peshtalevë, Llazhan dhe Debresht. Torbeshët më kompakt janë në Debresht, të pranishëm janë edhe në Peshtalevë dhe Llazhan. Boshnjakët janë të vendosur në vendbanimet: Zhitoshë, Llazhan dhe Desovë.

## 1. CËRNILISHTË

**Pozita gjeografike:** Cërnilishta është fshat i Komunës së Dollnenit (Prilep). Gjeografikisht shtrihet në anën veriperëndimore, nja 25 km larg qendrës komunale, aty ku mbaron ultësira e Pelagonisë, në një lartësi mbidetare prej 646 metrash.

**Kufizohet me këto vendbanime:** Straja (Strovija, sllav.) V: Gostirashi (Gostirazhni) VL: Sliepçe (Slepçe) JL: Kostince (Kostinci) J: Mallgaraja (Margari) VP: Dollgoveci (Dollgoec) P: Xërxe (Zrxe) JP. Përveç 6 shtëpive të kombësisë maqedonase, të gjithë të tjerët janë të kombësisë shqiptare, të fesë muslimane.

**Statistikat mbi numrin e popullsisë:** Më **1900** sipas (*Kënçov-MES,244*) ka pasur 720 banorë (60 maqedonas, 580 shqiptarë dhe 80 rom); Më **1902** (*Haxhi-Vas.-PNO, 27*) - 60 shtëpi të shqiptarëve; **1925** (*Traiçev- GP, 365*) - 740 banorë (80 maqedonas, 580 shqiptarë dhe 80 romë); **1948** – 949 banorë (201 maqedonas, 1 serb, 1 kroat, 2 mysliman, 733 shqiptarë, 1 turk, 10 romë); **1953** - 1045 banorë (201 maqedonas, 66 shqiptarë, 766 turq dhe 6 romë); **1961** - 1118 banorë (208 maqedonas, 19 shqiptarë, 884 turq, 1. rom dhe 1 mysliman); **1971** - 1108 banorë (145 maqedonas, 9 shqiptarë, 922 turq); **1981** - 1303 banorë (62 maqedonas, 175 shqiptarë, 928 turq, 104 mysliman, dhe 64 nuk janë përcaktuar **1994** - 1486 banorë (34 maqedonas, 1209 shqiptarë dhe 243 turq). **2002** – 1773 banorë (1720 shqiptarë, 10 maqedonas dhe 43 turq).

**Fiset kryesore:** Në fshatin Cërnilishtë sot jetojnë disa fise të vjetër dhe disa të ardhur. Fiset e sotshëm të vjetër gjenealogjinë e vet e dinë nga brezi i katërt dhe i pestë. Fiset e vjetra me më shumë shtëpi janë **Ali«vsi** (<hip.Ali), **Bal«vsi** (<hip.Bajram), **Cank«vsi** (<hip.Asan), **Çollak«vsi** (< nga nofkë), **Gaq«vsi** (<nga nofkë), **Galak«vsi** (<nga emri i një zogu që ka ngjyrë të zezë, Gal, galica (Pyrrh. ocorax gracalus), **Gjolek«vsi** (të ardhur nga Dardha, vend në Shqipëri) (<hip.Gjon + Lekë), **Guxh«vsi** (<nga nofkë), **Kaçkin«vsi** (<nga nofkë), **Kas«vsi** (<hip.Kasim), **Lat«vsi** (<hip. Iljaz), **Lik«vsi** (<hip.Ali), **Manç«vsi** (<hip.Osman), **Mull«vsi** (<nga nofkë), **Pup«vsi** (<nga nofkë), **Qamil«vsi** (<hip. Qamil), **Reç«vsi** (<hip.Rexhep), **Shit«vsi** (<hip. Rushit), **Us«vsi** (<hip.Usein), **Xhep«vsi** (<hip.Rexhep), **Zanç«vsi** (të ardhur nga Zajazi i Kërçovës), (<hip.Zani),

**Mëhallat:** Ekzistojnë tri mëhalla më të mëdha: Malla e Epër, Malla e Poshtme dhe Malla e Gaqievsvive.

**Etimologjia e emrit:** Lidhur me emrin e këtij fshati ka disa mendime, por më të bindshme më duken këto: banorët e këtij fshati emrin Cërnilishtë e nxjerrin nga fjalët: crni + alishta (tesha të zeza) nga një legjendë kur një gruajë nga kolera i kanë vdekur të gjithë nëntë fëmijët dhe është betuar se gjithmonë do të vishet me tesha të zeza. Mendimi i dytë është se fjala Cërnilishtë rrjedh nga fjala Crnil(o), pra nga fjala sllave crn "niger" -i zi, dhe prapashtesa ishte, pra Crnilishte, ashtu siç thekson Olga Ivanova: Për fshatin Cërnilishtë të Sveti Nikollës".

**Etniku:** Cërnilishtan (m), cërnilishtank (f), cërnilishtanët (sh)

**Informatorë:** Zera Ibrahim (1920-1998), pa shkollë, amvise; Vidan Razmoski, i lindur 1942, tetëvjeçare, punëtorë; Rushan Rushani, punëtorë, Rexhep Ibrahim, arsimtar.

## 2. DESOVË

**Pozita gjeografike:** Desova gjendet 5 km larg qytetit të Prilepit, në të djathtë rrugës rajonale Prilep – Makedonski Brod. Së pari hyhet në fshatin Mazhuqishtë, duke vazhduar pastaj rrugës gjarpërore deri në fshatin Desovë. Rruga deri atje është e asfaltuar, dhe derisa të arrish sytë kënaqen me bukuritë e rralla që në anën e majtë ofron rrafshnalta e Pellagonisë, e në anën e djathtë lëshohen shpatiet e malit me shkëmbinj të mëdhenj.

**Kufizohet me këto vendbanime:** Brailloven, Dollnenin, Zabërçanin, Dubleqanin dhe Drenovcën

**Statistikat mbi numrin e popullsisë:** Në **1900** (Kënçov -MES, 247) ka pasur 740 banorë (40 maqedonas, 625 shqiptarë dhe 75 romë); Më **1925** (Traiçev - GP, 365) ka pasur 700 banorë (50 maqedonas dhe 650 shqiptarë); **1948** – 1551 banorë (17 serbë, 407 maqedonas, 1 mysliman, 1086 shqiptarë, 9 turq, 31 ciganë); **1953** - 1627 banorë (423 maqedonas, 79 shqiptarë, 952 turq, 3 serb, 12 jugosllav dhe 157 të tjerë); **1961** - 1740 banorë (706 maqedonas, 1 shqiptar, 957 turq, 41 serb, 2 jugosllav, 1 të tjerë); **1971** - 1481 banorë (623 maqedonas, 2 shqiptarë, 439 turq, 417 të tjerë); **1981** - 1329 banorë (323 maqedonas, 34 shqiptarë, 777 turq, 3 serb, 2 të tjerë); **1994** - 1080 banorë (153 maqedonas, 228 shqiptarë, 91 turq, 1 serb, 607 të tjerë); **2002** – 1014 banorë (309 shqiptarë, 101 maqedonas dhe 604 boshnjakë).

**Fiset kryesore:** Svagovcit, Gogovci, Shabanovci, Bajraktarët, Dibranët, Gaçievci, Çergovci, Shakovci, Mërsharët.

**Etimologjia e emrit:** Për prejardhjen e emrit ekzistojnë dy teori. Sipas L.Stankovska emri i fshatit rrjedh nga emri personal *Deso* (*Desimir, Desislav, Despot* e tjerë).<sup>5</sup> Por sipas autorit emri i fshatit Desovë lidhet me bazën *Des* + suf. *-ovo*. Në bazën *Des* shihen gjurmët e fisit ilir të *Desaretëve*. *Proces që takojmë edhe në toponime tjera balkanike, siç janë: Perast (<Pirusti), Dukla*

---

<sup>5</sup> Q u b i c a S t a n k o v s k a, Reçnik na liçnite iminja kaj Makedoncite. Skopje 1992, f.94.

(<Dokleati), Tara (<Autariati), Tale (Taulanti).<sup>6</sup> Fiset : *Ajr<sup>u</sup>ovsi* (të ardhur nga Cërnilishta), *Saret* (të ardhur më vitin 1975 nga f. Jabollçishtë të Velesit).<sup>7</sup>

**Etniku:** desovar (m), desovark (f), desovarët (sh)

**Informatorë:** Shefik Ahmet (1909-) (realizuar më 2002), Afedin Ahmeti (1969), arsimtar.

### 3. GOSTIRASH (GOSTIRAZHNI)

**Pozita gjeografike:** Fshati Gostirash gjendet në pjesën më veriore të rrafshnaltës së Pelagonisë. Fshati është vendosur nën shpatiet e malit Babuna, në një lartësi mbidetare prej 730 metra mbi nivelin e detit.

**Kufizohet me:** Strajën (Strovija), Cërnilishtën, Sliepçen, Oreshjen dhe Bogomaillën.

**Statistikat për numrin e popullsisë:** Në regjistrimin e vitit **1953** ka numëruar 488 banorë (486 maqedonas, 2 serb); **1961** - 431 banorë (403 maqedonas, 23 turq, 4 serb, 1 mysliman); **1971** - 280 banorë (269 maqedonas, 10 turq, 1 të tjerë); **1981** - 206 banorë (149 maqedonas, 12 shqiptarë, 9 turq, 1 serb, 6 të tjerë); **1994** - 110 banorë (60 maqedonas, 34 shqiptarë, 16 turq); **2002** – 108 banorë (63 shqiptarë dhe 45 maqedonas). Njeriu i parë që përmendet është Gon Arnaut.<sup>8</sup>

**Fiset kryesore:** Zuberovci, Buzliovci, Qanievci, Sharetët, Sencës. Më parë kanë qenë edhe familjet: Milloshevci, Sekullovc, Koçevci, Tërpejci, Nikollovci (të ardhur nga Korça).<sup>9</sup>

**Mëhallat:** Gostirashi i vjetër, Ke Çeshmja

**Etimologjia e emrit:** Si e ka marrë emrin nuk dihet. Në defterët turk ky fshat emërohet si **Kostrazhne**<sup>10</sup>, serbët dhe bullgarët e emërojnë si **Gostirazhni**, kurse shqiptarët **Gostirash**. Disa në fshat mendojnë se emri vjen nga ajo se fshatarët janë shumë mikpritës.

**Etniku:** gostirashli (m), gostirashlink (f), gostirashlit (sh)

**Informatorë:** **Informatorë: Teurat Isoski**, i lindur më 1962, të mbaruar 8 vjeçaren, me profesion bujk; **Dimko Todoroski**, i lindur më 1922, nëpunës. (Është shfrytëzuar libri i tij: „*Gostirazhni – gjeografski, istoriski i etnologjiki zapisi*„, Битола 2007).

### 4. PESHTALEVË (PESHTALEVO)

**Pozita gjeografike:** Fshati Peshtalevë gjendet nja 25 km nga Prilepi, në anën e djathtë të magjstrales Prilep – Makedonski Brod, pas fshatit Ropotovë. Shtrihet në rrafshnaltën e Pelagonisë.

**Kufizohet me:** Ropotovën, Rilovën, Slivjen, Dollnenin, Kostincen, Sekircen, Braillovën, Sarandinin.

**Statistikat për numrin e popullsisë:** Në vitin **1925** (G.Traiçev -GP,365) ka pasur 509 banorë

---

<sup>6</sup> Mustafa Ibrahim i, Gjurmë ilire në ojkonimin “Desovë”(treva e Prilepit), Flaka e vëllazërimit”, 01.04.1994, f.17; Shih edhe në *Interpretime dhe studime gjuhësore*, Shkup, 2003, f.87-89.

<sup>7</sup> Sipas fjalëve të Vebi Nezirit i lindur më 1928, tregonte se në Jabollçishtë kanë ardhur nga Reka e Gostivarit para 300 vjetësh.

<sup>8</sup> *Turski dokumenti za makedonskiot narod – opuiren popisen defter no.4*, viti 1467-1468, nën redaktimin e Metodija Sokollovski dhe dr. Aleksandar Stojanovski, Skopje 1971

<sup>9</sup> Dimko Petrov Todorovski, *Gostirazhni*. Bitola 1997, f.13.

<sup>10</sup> *Turski dokumenti za makedonskiot narod – opuiren popisen defter no.4*, viti 1467-1468, nën redaktimin e Metodija Sokollovski dhe dr. Aleksandar Stojanovski, Skopje 1971, f.46.

(70 maqedonas dhe 439 turq); **1953** - 607 banorë (4 maqedonas, 5 shqiptarë, 581 turq, 15 rom); **1961** - 438 banorë (211 maqedonas, 1 shqiptar, 225 turq, 1 jugosllav dhe 1 të tjerë); **1971** - 500 banorë (396 maqedonas, 94 turq, 2 serb, 8 të tjerë); **1981** - 500 banorë (368 maqedonas, 62 turq); **1994** - 448 banorë ( 228 maqedonas, 23 shqiptarë, 137 turq); **2002** – 448 banorë (150 shqiptarë, 178 maqedonas dhe 120 turq).

**Fiset kryesore:** Abdiovci, Alitovci, Baliovci, Bunevci, Jajovci, Lavevci, Manevci, Oxhovci, Sadikovci, Selimovci, Sinanovci, Usevci, Zenovci

**Mëhallat:** Malla e Zenovce, Malla Xhelovci, Malla Sadikovci, Malla Lavevci, Malla Selimovce, Malla Sinanovce

**Etniku:** peshtanli (m), peshtalovk (f), peshtanlit (sh)

**Informatorë:** Seil Selimoski, i lindur më 1935, 2 klasë shkollë, bujk. (29.07.2010).

## 5. **DEBRESH (DEBRESHTE)**

**Pozita gjeografike:** Debreshi është fshat që gjendet në veriperëndim të Prilepit dhe bën pjesë në komunën e Dollnenit.

**Kufizohet me:** Bellushinën, Jakrenovën, Borinën, Zhitoshën, Llazhanin dhe Ropotovën.

**Statistikat mbi numrin e popullsisë:** Sipas regjistrimit të vitit **1948** fshati ka numëruar 2791 banorë (1123 maqedonas, 1 serb, 1 malazez, 1146 shqiptarë, 493 turq, 26 romë 1 tjerë); **1953** - 2595 banorë (502 maqedonas, 5 shqiptarë, 2080 turq, 2 serb, 1 jugosllav); **1961** - 2394 banorë (995 maqedonas, 1386 turq, 8 serb, 2 jugosllav, 1 të tjerë); **1971** - 2405 banorë (844 maqedonas, 14 shqiptarë, 1319 turq, 417 të tjerë); **1981** - 2395 banorë (437 maqedonas, 45 shqiptarë, 23 të tjerë). **1994** - 2319 banorë ( 210 maqedonas, 85 shqiptarë, 2011 turq, 1 serb, 12 të tjerë); **2002** – 2350 banorë (150 shqiptarë, 220 maqedonas dhe 2000 turq).

**Fiset kryesore:** *Abovce, Ajdarovce, Ajrovce, Arapoxhovce, Batallovci, Beadinovce, Belulovci, Camevce, Çelikovce, Çelovce, Demkovce, Drenovci, Durakovce, Durmovce, Fazliovci, Feratovce, Ibevci, Ibovci, Ismailefendiovci, Miftarovce, Muaremovce, Musalevci, Mutalevce, Nexirovce, Ramçevce, Ramçevce, Rexhovce, Sadullovc, Sherifovci, Shilevce, Topallovce, Ziberovce*

**Mëhallat:** Malla e Batallovce, Malla e Durakovce, Malla e Muaremovce, Malla e Abovce Malla e Shilevce, Malla e Ibovce, Malla e Ajdarovce, Malla Poshtër

**Etimologjia e emrit:** Rrjedh nga një emër personal Debres, të cilin në mesjetë e mbanin edhe shqiptarët, shih Prodani, b.Debreskos (Krushnicë – Poreçe TD 255).

**Etniku:** debreshtanli (m), debreshtank (f), debreshtanlit (sh)

**Informatorët:** Sadula Sadulloski i lindur më 1918, 8 vjet shkollë, bujk (realizuar më 1999); Mefmet Beçiroski, i lindur më 1916, pa shkollë, bujk; Zekman Ibeski, i lindur më 1931, 4 vjet shkollë, bujk (29.07.2010).



## 6. LLAZHAN (LLAZHANI)

**Pozita gjeografike:** Fshati Llazhan shtrihet veriperëndim të Prilepit, nja 15 km larg qendrës në të majtë të rrugës Prilep – Makedonski Brod.

**Kufizohet me:** Debreshin, Sredorekun, Koshinon, Sazhdovën, Jakrenovën, Borinën dhe Zhitoshen.

**Statistikat mbi numrin e popullsisë:** Në vitin **1948** – 1170 banorë (75 maqedonas, 926 shqiptarë, 44 turq, 125 ciganë); **1953** - 1239 banorë (155 maqedonas, 1 shqiptarë, 1060 turq, 23 romë); **1961** - 1397 banorë (415 maqedonas, 957 turq, 3 serb dhe 3 jugosllavë); **1971** - 1709 banorë (607 maqedonas, 822 turq, 3 serb, 277 të tjerë); **1981** - 1955 banorë (514 maqedonas, 51 shqiptarë, 1 turk, 1047 mysliman, 17 jugosllavë); **1994** - 1827 banorë ( 327 maqedonas, 34 shqiptarë, 464 turq, 1 serb, 994 të tjerë). **2002** – 1857 banorë (100 shqiptarë, 300 maqedonas, 427 turq dhe 1030 boshnjakë).

**Fiset kryesore:** **Bibiqi** (bosh.), **Braovci** (tur.), **Bronja** (bosh.), **Cenovci** (tur.), **Cukovci** (tur.), **Fazliovci** (shq.), **Gërbaçovci** (tur.), **Ibishovci** (tur.), **Jajovci** (tur.), **Jasharovci** (tur.), **Kamberovci** (tur.), **Karishik** (bosh.), **Kashevci** (tur.), **Kerimovci** (shq.), **Kollashinci** (bosh.), **Lokmanovci** (tur.), **Nexhipovci** (tur.), **Raifovci** (shq.), **Saitovci** (shq.), **Shaqirovci** (tur.), **Sherifovci** (tur.), **Shishkovci** (tur.), **Shkrialaj** (shq.-bosh.), **Sulejmanovci** (tur.), **Tuntovci** (shq.), **Turevci** (tur.), **Zijadiç** (bosh.)

**Mëhallat:** Ke Çairët, Ke shkrelajt, Ke Zengovcit, Ke Tuntevcit, Ke Shitovcit

**Etniku:** llazhanli (m), llazhank (f), llazhanlit (sh)

**Informatorët:** Qamil Shkreli (1922) bujk (realizuar 2003), Qamil Raifoski, i lindur më 1936. Shkollë 4 vjeçare. Me profesion bujk. (Intervista u realizua më 29.07.2010).

## 7. ZHITOSHË (ZHITOSHE)

**Pozita gjeografike:** Gjendet në skajin veriperëndimor të rrafshit të Pelagonisë, nja 20 km larg Prilepit. Deri në këtë fshat arrihet nëpërmjet rrugës rajonale Prilep – Makedonski Brod, duke kthyer në të majtë në fshatin Ropotovë, dhe duke kaluar Llazhanin.

**Kufizohet me:** Nerovën, Sellcën, Bellushinën, Jakrenovën, Llazhanin, Borinën, Llokvenin, Sredirekun, Vrançen.

**Statistikat mbi numrin e popullsisë:** Në Zhitoshe të Epërme më **1467/8** (PPI-137) ka pasur 52 familje; **1544/5** - 37 familje. Në Zhitoshe të Epërme më **1467/8** ka pasur 43 familje; **1544/5** ka pasur 56 familje. Më **1900** (Kënçov -MES, 245) ka pasur 701 banorë (66 maqedonas, 560 shqiptarë dhe 75 romë); **1971** - 1622 banorë (9 maqedonas, 61 shqiptarë, 888 turq, 6 serbë, 658 të tjerë); **1981** - 1757 banorë (4 maqedonas, 1239 myslimani, 183 shqiptarë, 8 serb dhe 1 rom); **1994** – 1773 banorë ( 190 maqedonas, 1054 shqiptarë dh 86 turq, 8 serb dhe 622 të tjerë); **2002** – 1926 banorë (1200 shqiptarë, 20 turq, 700 boshnjakë dhe 6 serb).

**Fiset kryesore:** Afuzovci, Ballabnovci, Bozholevci, Deshatovci, Kerovci, Oxhovci, Saliçevci, Shutovci, Svagovci, Tuzirovci, Veshovci

**Mëhallat:** Malla Epër, Malla e poshtër, Dollna Zhitoshe

**Etimologjia e emrit:** Emrin e ka marrë nga gjuha sllave zhito që do të thotë grurë. Shih edhe **GRUNISHTA** – Fshat në rrethin e Manastirit. Petar Skoku e nxjerr nga fjala shqipe **grun** + suf. – **ishte**.<sup>11</sup> V.Mihajllioviq e nxjerr nga “**grunec**” – lloj peshku në liqenin e Ohrid. Krh. këtu edhe emrin Grunevski (Shkup TI 91), nga baza antroponimike e shqipes \***grun (grurë)**, krh. këtu edhe Grunjë-a, Grunja b. Kodinit (Shuteriq LSHPB 318).

**Etniku:** zhitosheli (m), zhitoshank (f), zhitoshelit (sh)

**Informatorët:** Mamut Asani (1926- ), pa shkollë: Sule Ademi (1922 -), pa shkollë (realizuar 1999); Ebil Emini, 75 vjeçar, bujk, 4-vjeç shkollë (korrik 2010).

### 3. Komuna e Krushevës

Territori i komunës së Krushevës e përfshinë pjesën juglindore të Pelagonisë, por me një pjesë edhe pjesën e sipërme të lumit “Crna Reka”. Krusheva kufizohet me Demir Hisarin, Krivogashtanin, Zhitoshen, Dollnenin, Makedonski Brodin, Pllasnicën, Vraneshticën dhe Sopotnicën. Vendin qendror e zë Krusheva, vendbanimet janë: Arilevë, Buçin, Vërboec, Gorno Divjaci, Dolno Divjaci, Milloshevë, Ostrillci, Presill, Pusta Reka, Sveto Mitreni dhe Sellce.

Në pikëpamje etnike, në komunën e Krushevës jetojnë disa nacionalitete. Popullata shqiptare jeton kryesisht në: **Borinë, Norovë, Alldance, Jakrenovë, Sazhdevë, Presill dhe Bellushinë**. Më parë shqiptarë ka pasur edhe në fshatrat **Dërnovcë, Pribillcë, Novosellë, Zagoricë, Ivanovcë, dhe në Vërboec**. Këta fshatra nga administrata osmane janë konsideruar si fshatra të pastra shqiptare<sup>12</sup>.

### 8. JAKRENOVË (JAKRENOVO)

**Pozita gjeografike:** Fshat në jugperëndim të Prilepit, i banuar edhe sot me shqiptarë.

**Kufizohet me këto vendbanime:**

**Statistikat mbi numrin e popullsisë:** Më **1467/8** (PPI-138) ka pasur 17 familje ë **1544/5** ka pasur 27 familje. Më **1900** (Kënçov -MES, 246) ka pasur 130 banorë (30 maqedonas, 100 shqiptarë); **1971** - 236 banorë (8 maqedonas, 36 shqiptarë, 180 turq, 1 serb, 11 të tjerë); **1981** - 209 banorë (95 myslimanë, 81 shqiptarë); **1994** - 211 banorë (0 maqedonas, 84 shqiptarë, 98 turq dhe 29 të tjerë); **2002** – 201 banorë (101 shqiptarë, 50 turq dhe 50 boshnjakë).

**Etimologjia e emrit:** Tek emri i këtij topiku gjejmë të përbashkët një emër vetjak i krishterë **Jak** a **Jakrenovë**, i përhapur edhe sot te shqiptarët, krh. **Jak** e **Jaku** si emër dhe mbiemër familjar te shqiptarët e Kosovës etj.<sup>13</sup>

**Etniku:** jakrenovalid (m), jakrenovalid (f), jakrenovalid (sh)

<sup>11</sup> Petar Skok, *Iz Toponomastike Južne Srbije*, f.145.

<sup>12</sup> *Turski uzvori za ajdustvoto i aramistvoto vo Makedonija 1600-1700*), Shkup 1961, dok..nr.130.

<sup>13</sup> Q.Murati DOASH 15.

**Informatorët:** Nijazi Alimi, 80 vjeçar, 4-vjeç shkollë, bujk; Zija Izeiri, 65 vjeçar, pa shkollë, bujk.

## **9. SAZHDOVË (SAZHDEVO)**

**Pozita gjeografike:** Gjendet në pjesën veriperëndimore të rrafshit të Pelagonisë. Bën pjesë në komunën e Krushevës.

**Statistikat mbi numrin e popullsisë:** Më **1467/8** (PPI-137) ka pasur 26 familje; **1544/5** ka pasur 30 familje. Më **1900** (Kënçov -MES, 246) ka pasur 154 banorë (130 shqiptarë dhe 24 romë); **1971** - 222 banorë (66 maqedonas, 4 shqiptarë, 141 turq, 2 serb dhe 9 të tjerë); **1981** - 278 banorë (4 maqedonas, 11 myslimanë, 41 shqiptarë, 1 kroat); **1994** – 316 banorë (1 maqedonas, 108 shqiptarë, 199 turq, 8 të tjerë); **2002** – 281 banorë (104 shqiptarë, 170 turq dhe 10 boshnjakë).

**Etniku:**sazhdovali (m),sazhdovalink (f), sazhdovalit (sh)

**Informatorët:** Alisulejman Rufati, i lindur më 1955, 8 vjet shkollë, punëtor; Aziz Ibrahimimi i lindur më 1912 -, pa shkollë, bujk (realizuar 1999); Bajram Limani, 63 vjeçar, 8-vjeçare, bujk (realizuar 2010).

## **10. BELLUSHINË (BELLUSHINO)**

**Kufizohet me këto vendbanime:** Jakrenovën, Borinën, Sellcen, Dërnovën, Rilovën, Pusta rekën, Divjakun.

**Statistikat mbi numrin e popullsisë:** Më **1467/8** (PPI-137) ka pasur 21 familje; **1544/5** ka pasur 36 familje. Më **1900** (Kënçov - MES, 247) ka pasur 300 banorë të gjithë shqiptarë; **1971** - 135 banorë (7 maqedonas, 8 shqiptarë, 118 turq dhe 2 të tjerë); **1981** - 127 banorë (maqedonas, 2 shqiptarë.); **1994** - 72 banorë (63 maqedonas, 9 shqiptarë); **2002** – 70 banorë (70 shqiptarë).

**Fiset kryesore:** Ajrovci, Bajramovci, Cakovci, Idrizovci, Rexhepovci

**Etniku:** bellushanli (m), bellushank (f), bellushanlit (sh)

**Informatorët:** Nazim Idrizi, i lindur më 1948, 8 vjeçare, bujk; Njazi Xhelili, i lindur më 1946, 4 vjeçare, bujk; Sejdi Alili, i lindur më 1985, student; Erduan Idrizi, i lindur më 2001, nxënës (prill 2010).

## **11. BORINË (BORINO)**

**Kufizohet me këto vendbanime:** Borina, Zhitoshe, Llazhan, Shezhdovë, Jakrenovë, Bellushinë.

**Statistikat mbi numrin e popullsisë:** Më **1900** (Kënçov - MES, 246) ka pasur 200 banorë, të gjithë shqiptarë; **1971** - 444 banorë (4 maq., 4 shqiptarë, 339 turq, 37 të tjerë); **1981** - 474 banorë (2 maq., 203 mysliman, 41 shqiptarë, 7 jugosllavë); **1994** - 438 banorë (0 maq., 290 shqiptarë, 37 turq,

111 të tjerë); **2002** – 476 banorë (352 shqiptarë, 19 turq dhe 105 boshnjakë).

**Fiset kryesore:** Bilalovci, Sulemanovci, Sinanovci, Pulevci, Murovci, Eminovci

**Etimologjia e emrit:** (B-r-i-n-a TD 66) – fshat në perëndim të Prilepit. Në Defterin turk të regjistrimit e ndeshim me formën Brina, krh. këtu dhe Brinanc në Petriç. Kjo fjalë rrjedh nga emri vetjak shqiptar **Biran**, ky nga apelativi **bir,~i**, i terminologjisë familjare, që si i këtillë ka kaluar të përdoret edhe te maqedonasit.<sup>14</sup>

**Etniku:** borinali (m), borinalink (f), borinalit (sh)

**Informatorët:** Vait Amedi, i lindur më 1930, pa shkollë, bujk; Isenferit Amedi, i lindur më 1962, 8 vjeçare, bujk. (Realizuar më 03.08.2010)

## 12. ALLDANÇE (ALLDANCI)

**Kufizohet me:** Nerovën, Zhitoshën, Borinën, Vërbbovcin, Sveti Mitranin dhe Grazhdanin.

**Statistikat mbi numrin e popullsisë:** Më **1467/8** (PPI-143) ka pasur 29 familje; **1544/5** ka pasur 24 familje. Emri është shënuar si **Haldanci**. Më **1900** (Kënçov -MES, 245) ka pasur 270 banorë, të gjithë shqiptarë; **1971** - 548 banorë (149 maqedonas, 24 shqiptarë, 320 turq e të tjerë); **1981** - 459 banorë (52 maqedonas, 20 myslimanë, 67 shqiptarë); **1994** - 414 banorë (15 maqedonas, 294 shqiptarë, 105 turq); **2002** – 450 banorë (425 shqiptarë dhepovci, 25 maqedonas).

**Fiset kryesore:** Kostenja, Roçi, Kolaj, Mullaj, Hoxhaj, Mixhaj, Dibra, Gazinj, Gaçi, Malushaj dhe Disha. Alimovci, Kolevci, Raçe, Ademovci, Mixhovci, Dibranovci, Jakupovci, Mullovci, Tavçevci, Litovci, Ferid Sinan Gaziut

**Etniku:** alldançeli (m), alldançelink (f), alldançelit (sh)

**Informatorët:** , Verit Velu (1904-), pa shkollë, bujk; Aliriza Velu (1948), fakultet, Sadetin Roçi (1964), tetëvjeçare (realizuar 2003); Ademselim Jakupi, 4-vjeç shkollë, bujk (prill 2010)

## 13. NEROVË (NEROVO)

**Kufizohet me:** Alldançen, Sellcen, Zhitoshen

**Statistikat mbi numrin e popullsisë:** Më **1467/8** (PPI-137) ka pasur 54 familje; 1544/5 ka pasur 23 familje. Më **1900** (Kënçov -MES, 245) ka pasur 290 banorë, të gjithë shqiptarë; **1971** - 444 banorë (6 maqedonas, 8 shqiptarë, 430 turq); **1981** - 464 banorë (1 maqedonas, 3 myslimanë, 454 shqiptarë); **1994** - 542 banorë (0 maqedonas, 532 shqiptarë, 9 turq dhe 1 të tjerë). **2002** – 600 banorë (600 shqiptarë).

**Fiset kryesore:** Ramovci, Baçovci, Selimovci, Imerovci, Muratovci, Shkandovci, Islamovci, Xhemalovci, Dautovci, Telkofci, Bezatovci, Nebiovc, Dushku, Quska, Liçi, Baçi, Titi, Palaj, Mareqi, Toskaj, Puret, Tolaj, Shkandaj, Rrako, etj.

---

<sup>14</sup> Q.Murati, *Elementet e shqipes në gjuhët sllave jugore*. Prishtinë 1990, f.117.

**Mëhallat:** Malla Muratovce, Malla Baçovce, Malla Selimovce

**Etimologjia e emrit:** Fshat në rrethin e Krushevës. Ka prejardhje nga emri personal NERO, i dëshmuar edhe në rrethinën e Strugës nga vëllezërit Milladinovci, rrethinën e Shkupit (**Nerez**), në atë të Tetovës (**Nerashti**). Të gjitha këta emërtime shpjegohen nga një bazë të shqipes “**njeri**”.<sup>15</sup>

**Etniku:** nerovali (m), nerovalink (f), nerovalit (sh)

**Informatorët:** Rustem Rustemi (1939), 4 vjet shkollë, bujk (realizuar 21.03.1998);

#### **14. PRESILL (PRESILL)**

**Kufizohet me këto vendbanime:** Buçimi, Krusheani, Millosheva dhe Birina

**Statistikat mbi numrin e popullsisë:** Më **1467/8** (PPI-141) ka pasur 63 familje; 1544/5 ka pasur 67 familje; **1948** – 744 banorë (39 kroat, 97 maqedonas, 594 shqiptarë, 13 turq); **1971** - 579 banorë (270 maqedonas, 12 shqiptarë, 293 turq, 2 serb, të tjerë); **1981** - 556 banorë (147 maqedonas, 113 myslimani, 34 shqiptarë dhe 3 serb); **1994** - 481 banorë (37 maqedonas, 323 shqiptarë dhe 121 turq); **2002** – 410 banorë (400 shqiptarë dhe 10 maqedonas).

**Fiset kryesore:** Murataj, Rashitovci, Selimovci, Gjurevci, Remzovci, Modrevci

**Mëhallat:** Malla e Poshtëre, Malla e nalt

**Etniku:** presillali (m), presillalink (f), presillalit (sh)

**Informatorët:** Husein Huseini i lindur 1964, me shkollë të mesme, tregtar; Amdi Zeçiri, i lindur më 1955 pa shkollë, bujk (realizuar më 21.03.1999);

---

<sup>15</sup> Petar Hr. Ilievski, *Balkanski Lingvisti~ki Studii*, Skopje 1988 f.540.

Kreu i dytë

KËNGËT E DASHURISË

DHE TË DASMËS

## 1. KËNGËT E DASHURISË

Dashuria është një veprim normal i njeriut në rrethana e kushte të ndryshme. Personazhet kryesore janë dy të rinjtë, vajza dhe djali, por mund të jenë edhe të moshave tjera. Qysh kur u shfaq dashuria në mes dy personave nuk ka munguar as krijimi artistik mbi ato ngjarje. Pra, ndjenjën e dashurisë, populli e ka shprehur e kënduar nëpër këngë. Këngët e dashurisë janë një nga zhanret më sasiore dhe më cilësore të lirikës sonë popullore.

Këto këngë parasëgjithash shprehin botën intime të të rinjve mbi nevojën e kontakteve të dy gjinive të kundërta, afrinë dhe bashkimin e tyre për jetë dhe ardhmëri të lumtur. Edhe pse në këtë lloj krijime kemi një lirikë të pasur dhe të bukur erotike, ku i këndohet dashurisë së sinqertë, populli me xhelozë e ka ruajtur këtë dashuri, ashtu që nuk ka mundur ta zbeh as fanatizmi, as zakonet e prapambetura e as obskurantizmi i së kaluarës. Kjo ka ndodhur kështu, sepse në këto këngë erotike dashuria është një lidhje mbi bazë të ndjenjave të pastra njerëzore e besnikërie që pretendojnë për lidhje të përhershme martesore. Në këngët e dashurisë, përveç që idealizohen ndjenjat e fuqishme, që shprehin dy të rinjtë, në to pasqyrohet edhe mosrealizmi i shumë dëshirave, dështimeve, vuajtjet, pengesat etj. Burimi kryesor i këngëve për dashurinë është ambienti blegtoral bujqësor, pra fshati, dhe e bukura e këtyre poezive popullore që bujkësia dhe baresha.

Me transformimin e shoqërisë, në këto kënga futen edhe elemente tjera. Këngët e dashurisë, zakonisht këndohen në rrethet e të rinjve dhe të rejave. Ato këndohen në rrethe familjare, në festa e dasma dhe në përgjithësi janë të gëzueshme e u këndohet virtyeteve dhe bukurive kryesisht të vajzave.

Në regjionin e Pelagonisë kënga e dashurisë është mjaft e përhapur dhe gjeti trajtim të posaçëm në krijimet popullore. Për nga mënyra e ekzekutimit këngët në rrafshin e Pellagonisë janë pa përcjellje instrumentale, përveç dajres. Tingujt e melodive të këtyre këngëve janë në gradacion të ndryshëm emocionesh e ndjenjash, që shprehin karakterin e bukurisë së natyrës dhe botës shpirtërore shqiptare. (Ibrahimi 2003:63).

Ja disa këngë të mbledhura në Zhitoshë, Sazhdevë, Presill, Cërnilishtë e tjerë

**Moi e mejra me syt e zi**

Moi e mejra me syt e zi  
Dot ta vras moi qenin ty  
Not e dit lef në çat avllej  
Moma vrejt be gjalo  
Hajde mrom ke mu në shpej  
Kom lidh qenin me sinxhejr  
Ka shku nana gjal në miqsej  
Baba në Pazar porta qel dera pa dry

**Ani tej moi cuc**

Ani tej moi cuc me atë kmish basme  
Mos dil në avlli se zemrën ma plase  
Ani tej moi cuc me ato sey të zi  
Aq shumë ije të paskan  
Mos fillo dashnin mos fillo dashnin  
Moi se duhet ta majsh besën  
Kur ta japësh duhet të shkosh  
Unë besën ja kom dhan  
Tash ja jap dhe dorën  
Ne të dy kemi me u mar sa të mbaroj shkollën

**O moi e mira**

O moi e mira napër fera  
Tlutem tlutem sa erdh vera  
Mirat agën shumë e desha  
Vet e desha vet e mora  
Plasni shoqe për okoll

**Dikush e ka qesh Barijen**

Dikush e ka qesh Barijen dikush e ka qa  
Ka thon vllau i jon nanë vet unë e kam pa  
E kom pa unë vet menen ma ka mush



I ka vetllat e holla si rrush

**Informatori: Ilmije Mehmeti**  
**e lindur 09.01.1937, amvise fsh-Zhitoshë**

**Hypa në mollë**

Hypa në mollë e pash bel hollën  
Drit i lishonte balli  
Çish i thoshte djali  
Larg e pash o me dor ja bona  
Hajde moi bijë ke nana

**Bijen tri daire moi nanë**

Bijen tri daire moi nanë të trija me dor  
A se din mori nana ime, se unë nesër shkoj  
Edhe në shkofsh të qoftë udha e mar moi bijë  
Tu bezdis gjergjefi tu mu bo çorap  
Çajo dele e huaj moi bijë  
Fmijët shum e rokin  
Se ti e din të lumja moi bijë  
Ti dot rish në tokë dhe cullve të djepit du bojsh temena  
Kur do vish ke nana  
Do rish si mikesh  
Kur dot hajet buk ke manxhja sun gjesh  
Kur dot pijet ujë, shtamën sun e gresh  
Llafet sti haroj moi nanë deri sa të jem gjallë

**Informatori: Rabije Ajrullai**  
**e lindur 11.02.1956**  
**profesioni Amvise fsh-Bellushin**

**O për hajr**

O për hajr o me të marë  
More djal, çish nai bone kjet dasëm  
More djalë  
Po e gëzove nanën e babën

Ene farefeysin  
O ky dhandri me pare more djalë  
O arë o gurbetçar more djalë

**O ki deti ova ova**

O ki deti ova ova thot Azizja nane shkova  
Qaj moi nane mos pusho  
Se Azizen de kërkosh  
O ki deti ova ova thot Azizja babe shkova  
Qaj morë babe mos pusho se Azizen de kërkosh  
Shum punova, shumë qendisa  
Gjalit të agës ja çova

**Informatori: Atixhe Memedoska**  
**e lindur 13.07.1960**  
**profesioni Amvise fsh-Sazhdevë**

**Ajde djalo i ri nama besën-o**

Ajde djalo i ri nama besën-o  
Të shkojm te kërkojm vetull zezën-o  
Vetull zezën nuk nai ipte baba-o  
Mere me të ik mere me inat  
Imi famili e madhe sun na bojn azgjo  
Ajde djalo i ri nama besën-o  
Të shkojm te kërkojm vetull zezën-o  
Vetull zezën nuk naj ipte nana-o  
Mere me të ik pike loma-o

**Vjen moi nane mollaxhiu, molla po na shet**

Vjen mollaxhiu molla me na shit  
Vet jemi molla vet jemi të holla  
Shporu be kopil sa nai more ment  
Vjen moi nane dardhaxhiu dardha me na shit  
Vet jemi dardha vet jemi të bardha  
Shporu be kopil se mi lujte ment  
Vjen moi nane pjeshkaxhiu pjeshka me na shit

Vet jemi pjeshka vet jemi kaleshka  
Shporu pizdevenk se mi lujte ment

**Informatori: Mirem Saliu**  
**e lindur 01.05.1969**  
**profesioni Amvise në fsh. Zhitoshe**

**A tët ap moi bija ime**

A tët ap moi bija ime për një fukara  
Se dua baba ime se dua  
Atë e fkasin fukara mu dem çue pa para  
Se dua baba ime se dua  
A tët ap moi bija ime për një katunar  
Se dua baba ime se dua  
Atë e fkasin katunar mu dem çue me magar  
A tët ap moi bija ime për një gjal i ri  
E dua baba ime e dua  
Atë e fkasin djal i ri mu dem çue me flori  
A tët ap moi bija ime për një amerikan  
E dua baba ime e dua  
Atë e fkasin amerikan mu dem çue me ajroplan

**Moi Lulie**

Moi Lulie moi Lulie  
Me gjergjefin jak të rime  
Ene nët paft Lulie baba thuj se mlodha një grusht me thana  
Oj Lulie moi Lulie  
Mer gjergjefin jak të rime  
Unë po vit po spom len baba  
Thuj se mlodha një dor me dardha

**Informatori: Ava Sulejmani**  
**e lindur 06.07.1963**  
**profesioni Amvise fsh-Borinë**

## O KY DETI

O ky deti ova ova thot lulija nene shkova  
Shum punova shum qendisa  
Dylber ages krejt ja cova  
O ky deti vala vala thot lulija babe shkove  
Shum punova shum qendisa  
Dylber ages krejt ja cova

(Zeqiri 2010:3-Presill)

## BUFKEN MENJAN

Fllanxa neper lam  
Fllanxa neper lam  
Fodullin e dylber agesas njeri se bon  
Drejtore ylber bufken se mi lujte ment  
Mori e drejtova po sem kishte ije  
Lulije moj goj kutije

Fllanxa neper lam  
Fllanxa neper lam  
Fodulli I ylber ages as njeri se bon  
Drejtore ylber bufken se mi lujte ment  
Mori e drejtova po sem kishte ije  
Lulije moj goj kutije

(Zeqiri 2010:4-Presill)

## OJ LULIJE OJ E BARDHE

Oj lulije oj e bardhe  
A te tha baba udhe e mare  
Udhe e mare baba ka thena  
Lot per faqe ja kam lan

Oj lulije oj e bardhe  
A te tha nena udhe e mare  
Lot per faqe ja kam lane

Oj lulije oj e bardhe  
A te tha vllau udhe e mare  
Udhe e mare vllau ka then  
Lot per faqe ja kam len

(Zeqiri 2010:4-Presill)

#### AS E NANES - AS E BABES

As e nanes,as e babes  
Por e asan ages!  
Pet per mi pet cucat  
E katunit na vin vet  
Fkasin e bertasin  
A ka vend per mu?  
Ka ven per mu shoqe  
Ka vend per ty  
Kimi dylber agen  
Gjal per te martu

(Zeqiri 2010:2-Presill)

#### OJ LULIJE OJ ESMERE

Oj lulie oj esmere  
A dvjen era lule vere  
Lule vere lule vjeshte  
Dylber agen vet e deshte  
Vet e deshte vet e more  
Plasnjin shoqet pi okolle  
Plasnjin shoqet u plasnjin zemrat  
Se lulja esht e jona

(Zeqiri 2010:2-Presill)

## OJ LULIJE ME SYRIN E ZIE

*Oj lulije me syrin e zie*

Naj ruft zoti vllaun edhe tye  
Shkojshin e folshin se lulija nuk bon  
Kur na yni mrena era jorgovan  
Era jorgovan paska celun o  
Gojat e dushmanave jane mshelun o

Shkojshin e folshin se dylber aga met  
Kur ju lutem zotit per ma I mirin kismet

Ma I mirin kesmete ka pasun  
Me lulijen jan dashun

(Zeqiri 2010:2-Presill)

## 2. KËNGË FEJESE

Pjergull o mori pjergullo

Pjergullo mori pjergullo  
Me rrushin i dierdhun-o  
Kush të ka mliedhun-o  
Ai djali me bufkën e dierdhun-o  
Pjergullo mori pjergullo  
Me gjethet e derdhun-o  
Ai vajza e Alldanqes  
Me atë djalin me bufkën e derdhun-o

**Ke porta e madhe**

Ke porta e madhe shumë terma  
Ka përcejti dylber aga ene më pa  
Kur të pa bi-o qish të tha  
E çiti peslirën en ma dha

Ke porta e vogël shadërvan  
Kapërcejti dylber begu ene më pa  
Kur të pa çish të dha  
E çiti unazën ene ma dha

**Informatori: Nerdegjyl Sejdini  
e lindur në vitin 1954  
në fsh. Nerovë profesioni Amvisenë**

**Pet përmi pet**

Pet përmi pet  
Cucat e Presejlles na lusin vet  
Pyet njona tjetrën a ka vend për mu  
Ka vend vend për mu, ka vend për ty  
Kemi vllaun e burrit djal për të martu

**Hypa terma malit**

Hypa termo malit, zrypa teposht zallit  
Nëpër degët e ait  
Shtiva me çish gjeta  
E godita syzezën, syzezën ku më bonte çorapë  
Godita syzezën napër flet të pëllumbit-o

**Informatori:  
Kadrie Izeri  
Nezja Aliu**

### 3. RITET E DASMËS

Sipas fjalëve të prof.dr. Mustafa Ibrahim, në librin Thesari folklorik shqiptar nga rajoni i Pelagonisë, Flaka, Shkup 2003, nga faqja 75- 87, përshkruan hollësisht se si janë bërë ceremonitë e dasmës shtatë ditë para fillimit të dasmës. Ai thekson se “Në krahasim me të tjerat, këngët e dasmës janë më tepër të përhapura në këtë trevë si në fshatrat malore ashtu edhe në ato të rrafshit të pelagonisë. Këto këngë janë të shkurtuara, por që kanë njëfarë përmbajtje në vete, qoftë kur përmbajnë në vete elementin humoristik, satirik apo here-herë sarklastik, por pa një qëllim të keq” (Ibrahimi 2003:76).

Këngët e dasmës nisen të këndohen ndër grupet e vajzave dy ditë para se të fillojnë dasma pra atë ditë kur bëhen gati petkat e nuses dhe të nisen fisnikët të shkojnë te miqtë e rinj. Atë ditë vajzat e përgatisin shtëpinë për dasmë dhe duke punuar këndojnë këngë të ndryshme. E lavdërojnë djalin dhe nusen.

Meqë dasma është momenti më i lumtur dhe më i pritur në familje, vetvetiu u lindën rite të ndryshme dhe këngë të llojllojshme rreth dasmës. Këngët e dasmës në shtëpinë e dhëndërrit janë të shumta. Ata fillojnë kur merret rrizja (shenja e parë që e sjell "shkejzi" (mësi). Atëherë në atë shtëpi paraqitet një gëzim i madh gjithëfamiljar. Lajmërimin e këtij gëzimi e bëjnë vajzat e asaj familjeje. Tubohen të gjitha vajzat e lagjes dhe farefisit, dhe me defe në dorë këndojnë këngë për rizen por edhe dashurinë. Këngët këndohen nga ndonjë dritare që të ndëgjojë i tërë fshati.

Bie shini bie vdora  
Përmi uodën e Dylber begut  
Nauk o shini, nauk o vdora  
Osht kjo rrizja e Dylber begut

(Ibrahimi 2003:77).

Në fshatin Zhitoshë është shënuar variant:

#### **Bie shi bie vdor**

Bie shi, bie vdor  
Ke obori i Rexhep agës  
Mori nauk osht shi nuk osht vdor  
Janë këto kruqit e Rexhep agës  
Dil be babo shtieri mrena



Ce kan ardh mem marë mu

**Informatori: Barije Saliu**  
**e lindur në vitin 15.05.1949 në Zhothsë**  
**profesioni Amvise**

Një variant e kemi gjetur edhe në punimin seminarik nga lënda e Dialektologjisë të studentit Emir Zeqirit nga Presilla në vitin 2010, ku thuhet:

Bie shie bie vdore  
Te obori i Asan Agës  
Mori nuk eshte shie nuk eshte vdore  
Por jan petkat e asan ages  
Mori bie shie bie vdore  
Te obori I asan ages  
Mori nuk eshte shie nuk eshte bore  
Por eshte dasma e asan ages

(Zeqiri 2010:4-Presill)

Vajzat i këndojnë edhe shkejzit (mësitit) i cili luan rolin e ndërmjetësuesit. Në fillim njëherë sjell dhurata nga vajza, që është shenja e parë e pastaj edhe nga djali. Me këtë rast, vajzat i këndojnë nuses së ardhshme, e cila palon teshat dhe i përgatit për mësitin.

Top e ara zerdelia  
zerdelia o e bafqeve  
kjo lulia rain n'qardake  
tuj paltu o moj rizen-o  
ja bon azër, o moj shkejzit

(Ibrahimi 2003:77).

Pasi të kryhen këta formalitete, dhe tash më kur dihet se dy të rinjtë do të merren, familja e djalit fillon me përgatitjen e dasmës. Tri javë para dasmës, dasmori përgatitet duke blerë fustane për nusen. Pra hapi i parë është qepja e teshave të nuses. Me këtë rast merret nusja dhe dërgohet te rrobaqepësi për të marrë masë, që t'i ketë të sakta teshat.

Vauna shkallët maurit-o  
Maurit kallkanit-o

Sajova duqanit-o  
Çish duqane çilen-o  
Çish gërshan na mairen-o  
Çish petka na praiten-o  
Për lulien gatiten-o  
Për shtatin niten-o

(Ibrahimi 2003:77).

E diel

Një javë para se të fillojë dasma, zakonisht dita e diel, në shtëpinë e dhëndërrit prap mblidhen vajzat dhe familja më e afërt që ta qërojnë grurin, nga i cili pastaj shtypet "qeshqeku" grurë i zier dhe i shtypur. Me këtë rast vajzat i këndojnë edhe djalit edhe vajzës, duke ua bërë me dije se dasma oficijalisht prej sot fillon.

Amana more Dylber beg  
Fol e naise ne kiet dasëm  
E kum fol, e kum naisun  
Ja kum lan Jago-babës  
Të ma mliedhe farefaysin

(Ibrahimi 2003:78).

Kurse vajzës i thuhet me fjalët:

Naisu nause, naisu lulie  
Se jen t'ue nais, ojne grunin-o  
Aun jem naisun donedisun  
Saun e la more nanën vetun

(Ibrahimi 2003:78).

E hënë

Të hënë persëri, përveç vajzave në shtëpinë e dhëndërrit, që në mëngjes vijnë edhe gratë e fisit më të gjerë, të cilët duhet ta ftuallin bakllavën. Me këtë rast, më tepër i këndojnë nuses, e cila së shpejti do të duhet të ndahet nga familja.

Mori si të shkonin luot, moj Lulie

Saumëll nëpër faqe  
Mori ne të shkuonin, ne të derdhen  
Se aun u dajta pi nanës  
Mori si të shkonin luot, moj Lulie  
Saumëll nëpër faqe  
Mori ne të shkuonin, ne të derdhen  
Se aun u dajta pi shuoqeve.

(Ibrahimi 2003:107 - Cërnilishtë).

Edhe variant në Presill është afërsisht i njëjtë:

Si te shkonin lot mej lulije  
Si sumlla neper faqe  
O net me shkonjin o net me derdhen  
Se un de ndaem prej babes  
Mori mere baben jote  
Perplase per dhe  
Hyp ne lemuzin

Si te shkonin lot mej lulije  
Si sumlla neper faqe  
Mori net me shkonjin  
Net me derdhen  
Se un dot ndaem prej nenes  
Meri nanes jote një shami pi shkine  
Neve moj lulije  
Dot marim  
Ne mej lule ste lam  
Si te shkonjin lot mej lulije  
Si smulla neper faqe

Mori net me shkonjin  
Net me derdhen  
Se un dot ndaem prej vllaut  
Mori vllaut një kostum

Pi kauri  
Neve moj lulije  
Dot marim  
Ne mej lulije ste lam

(Zeqiri, 2010:3 - Presill)

E martë

Të martën, dasmori bën përgatitjet intensive për fillimin e dasmës. Këtë përgatitje e fillon me prerjen e mishit, zakonisht therret ndonjë ka.

E mërkurë

Këtë ditë në shtëpinë e dhëndërrit ekspozohen teshat që i ka përgatitur shtëpia e dhëndërrit, por edhe dhuratat nga farefisi. Të gjitha teshat janë të varura në murr, ku janë të shënuara edhe emrat se kush çka ka dhuruar. Këto tesha i vizitojnë një numër të madh të grave, dhe më pas komentohen. Aty janë të ekspozuara edhe ari dhe sende tjera të çmueshme. Vajzat duke kënduar, i çojnë porosi vajzës se së shpejti do t'ia sjellin teshat dhe arin që ia kanë blerë.

Bon konak baba xhypi, bon konak  
Se do t'vije Jago baba, bon konak  
Do ta bjere kuti rubën, bon konak

(Ibrahimi 2003:107 - Cërnilishtë).

E enjte

Tri ditë para se të fillojë dasma, kemi disa këngë kushtuar ritit të "petkaxhive". Petkaxhit janë të afërmit e familjes së dhëndërrit, të cilët janë të zgjedhur zakonisht në numër janë tek ose 13 ose 15 anëtarë, të cilët kanë për detyrë nuses t'ia dërgojnë fustanet dhe arrin që i ka blerë shtëpia e dhëndërrit. Të gjitha teshat janë mirë të përgatitura nëpër valixhe, dhe çdo i afërm mban nga një valixhe. Para se të nisen vajzat këndojnë:

Amanet nana xhypka  
Bon gati ojne drekën  
Gati osh, azër osh  
Qitu rize petkaxhive  
Petkaxhive të Dylber begut

Ose

Amanat moj nana xhypka  
Dil e shaif moj ç'na vjen audhës  
Çish me pa moj bija ime  
Jen d'vet te dhandrit, Dylber begut

(Ibrahimi 2003:81 - Cërnilishtë).

Ka dal baba i nuses ka shashtis  
Në lamë a do vin te marin nusen  
A jan bo pishman, simi bo  
Pishman xhypi si mi bo pishman  
Kur de shovish aga babën me qere  
Në lamë

(Akhije Saliu 2013 - Zhitoshë).

### **Ka shku vllau jone**

Ka shku vllau jone ka shku në Elbasan  
I ka than Atixhja blema një fustane  
O unë fustanin jalla ta kam ble  
O se ju bone nanës teme reje  
Ka shku vllau jone ka shkue në Gjermanie  
I ka than Atixhja blemi këto dymie  
O unë dymiat jalla ti kam ble  
O se ju bone babës teme reje

**Informatori: Kadrie Izeri**

**Nezja Aliu**

Për pritjen që duhet ta bënë prindërit e vajzës, vajzat këndojnë:

Metën petkaxhit në konak,  
paysin jalla ku ka konak?  
Ka konak ke Baba xhypi  
Baba xhypi pret konak  
Nana xhypka shtron çardak  
motra xhypka bon ni kafe  
me sheqere me sevdaje

me filxhanet e Lulies

(Ibrahimi 2003:81 - Cërnilishtë).

Bashkë me rrobat, nuses i dërgohet edhe kanaja, e cila i përdor për ngjyrosjen e flokëve dhe me këto shprehet fillimi i dasmës te nusja. Vajza pasi i vesh, gjoja pa dëshirë, rrobat që ia ka sjellë familja e burrit, pasi t'i marrë, me rend gratë ngryk del në dhomë tjetër dhe i heq ato e vishet sërish me rrobe vajzërie, deri të nesërmen kur vishet si nuse dhe pret gratë e fshatit që vijnë të shohin pajën, që ka përgaditur brenda afatit të fejesës.

E premte

Ditën e premte, që në mëngjes, shoqet e nuse mblidhen dhe e zgjojnë nga gjumi, duke i kënduar :

Gremu lulije gremu, lum kunata

Se kunata don ta laje Lulije kaj kananë...

(Ibrahimi 2003:81 - Cërnilishtë).

Këto këngë këndohen nga shoqet e nuses, dhe janë pikëlluese, pasi paraqitet faza e përfundimit të një jete rinore. Andaj nusja u drejtohet shoqeve dhe kunatës:

Iqmu moj shoqe, iqma të keqen

Se besa jam sëmu shoqja ime, dergjuno

(Ibrahimi 2003:82 - Cërnilishtë).

Shoqet i japin kurajë:

Mos m'u trem lulie

Mos m'u trem lum shoqja

Se shoqja ta kum dhan lulie

Dylber agën gjal i rie

(Ibrahimi 2003:82 - Cërnilishtë).

Mos qaj lule se dët prishet

Bukurija, bukurijën

Nuk e qaj e pash

Nanën u rop tu qajt

Nanën jote de pajtoim

Dhe llokumin do tja çoim

(Axihi Saliu 2013 - Zhitoshë).

Ndrësa, në shtëpinë e dhëndërrit, kryhen përgatitjet e fundit. Zakon është në këto treva që të shkohet (gryshet) në çdo shtëpi të bijave dhe të farefisit dhe të ftohet gratë e burrat të vijnë në dasmë që ta shtojnë gazmendin. Kur të vijnë bijat vajzat e reja në të hyrë të oborrit nisin këngën:

Majr e bone, bukur bone Dylber beg

Çish gazllove farefaysin Dylber beg

Farefaysin e Dylber agës

(Ibrahimi 2003:82 - Cërnilishtë).

E shtunë

Gazi dhe hareja shtohet sidomos ditën para sa të fillojë dasma. Më parë dita e parë e dasmës ishte e premtja, por tash dasmat nisin të shtunën. Te burrat këndohen këngë madje bien daullet dhe zurlet. Nën zërin e daulleve dhe zurllave e shtypin qeshqekun, gjë që tregon shumimin në familje nga çifti i ri, i cili do të fillojë një jetë të re. Te gratë ka vetëm dajre dhe vajzat që i bien defit. Vajzat e mahallës i këndojnë të gjitha nuset e me nuset më të reja. Deri sa biseda dhe katundarët që vijnë dhe palohen në rradhë ahengu arrijnë në kulm vajzat e thejnë këtë monotoni me zërin e tyre. Zakonisht në këto kënga, Përqeshet babai i nuses e lavdërohet shtëpia e djalit, si shtëpi bujare, shtëpi pasaniku, që ka gjithçka. Përveç "tamlit të zogut" siç thotë populli.

Rraini familija e nauses ku jeni

Shpaiet me kashta i kini

Shpaiët e familis zgrada jen

(Ibrahimi 2003:82 - Cërnilishtë).

Kështu shprehet qartë pasuria që ka burri duke përmendur edhe rindërtimin e shtëpisë që e ka bërë për dasmë, që nusja në fillim të shoh gjithçka që ka të mirët.

Gjithashtu vajzat i japin përkrahje nuses, se ka bë zgjedhje të mirë, dhe se të gjithë e xhelozojnë për këtë:

Moj lulie dilimi i bakllavës

Mair va bone caucave t'mallës  
Ani mair va bone, qi si ngjove  
Dylber agën vet e deshe, vet e more

(Ibrahimi 2003:83 - Cërnilishtë).

Një variant i njëjtë e gjejmë edhe në fshatin Presill.

Oj lulije dilmi i bakllaves o  
Mir va bone qe i lave te malles o  
Ani mir va bone qe si ngjove o  
Ani mir va bone qe si ngjove o  
Asan agen e deshte e more o

Oj lulije dilmi i tatlies o  
Mir va bone qe i lave te komshies o  
Mir va bone qe i lave te komshies o  
Ani mir va bone qe si ngjove o  
Ani mir va bone qe si ngjove o  
Asan agen e deshte e more o

(Zeqiri, 2010:3 - Presill)

Në mbrëmje te gratë bëhet sërish gëzim. Luhen shumë drama të shkurtëra popullore (kryesisht i luajnë gratë) duke i imituar burrat dhe gratë plaka. Poashtu përqeshet edhe i zoti i shtëpisë, si në vargjet:

Abaz aga qalla-qalla  
Zboet dasma ne me pralla  
Me ni luge me ni kaupe  
Me ni d'le bishte qaupe

(Ibrahimi 2003:83 - Cërnilishtë).

Ose

Ani buke mos shikoni  
Mo muloni nër peshterke  
Osht e nana e Dylber agës

(Ibrahimi 2003:84 - Cërnilishtë).

Kush foli u maru



Asan aga u martu  
Ja marshin te keqen  
Ja bafshin kurban

(Zeqiri, 2010:3 - Presill)

E diel

Posa zbardh dita zgjohen të gjitha gratë dhe bëhen gati të shkojnë ta marrin nusen. Në dasmën e dhëndërrit marrin pjesë të gjithë gratë e fshatit, të cilat për dy ditë sa zgjat dasma, vallëzojnë nuset dhe vajzat. Të dielën dhëndërrin nxirret në oborr, dhe në shoqëri të valles që i luajnë krushqit, dhëndërrin e qethin dhe e ruajnë, kurse të gjithë të pranishmit të ftuar në dasëm i dhurojnë para.

Për të shkuar që të marrin nusen nisen edhe dasmorët, kuptohet disa nga të afërmit e djalit. Edhe nëse është nusja nga larg, nisen të gjithë krushqit e ftuar në mënyrë të organizuar. Për të gjithë ata, nga familja e nuses është përgatitur drekë.

Këngët që këndohen kur merret nusja u drejtohen më së shumti nuses dhe familjes së nuses. Nuses edhe njëherë ia bëjnë me dije, se nuk kanë harruar se për çka kanë ardhur p.sh: Këto këngë këndohen te shtëpia e nuses.

Dullaku i lulies kutaia-kutaia  
Kutonje Lulije se do t'lam ke shpaia

(Ibrahimi 2003:85 - Cërnilishtë).

Provokuese janë edhe këngët drejtuar babait të nuses, i cili sikur dëshiron që të hamenden dhe mos t'ia marrin vajzën edhe atë ditë:

Ka dal baba o shashtis në lam  
A da vin ta marrin Lulien  
A jan bo pishman?

(Ibrahimi 2003:85 - Cërnilishtë).

Tringlloj legeni vjen  
Lito qeni, lefti zagari  
Ne tham Kozari nauk  
Qenka kozari qenka Lito  
Zagari.

(Akhije Saliu 2013 - Zhitoshë).

Va morëm lulen va lam ferat  
Ti kullose baba i lules derrat.

(Akhije Saliu 2013 - Zhitoshë).

Derisa të gostiten krushqit, nusja nusëron në shtëpinë e vet, kurse vajzat vazhdimisht këndojnë, dhe zakonisht këndohen këngë nënçmuese kundër nënës dhe babait të nuses:

Kjo nausja tone krejt me tel  
E lam nanën vete ne çengel  
Kjo nausja tone si bujare  
E lam babën vet si magar  
I ka livar veshët si zagar

(Ibrahimi 2003:85 - Cërnilishtë).

Ndarjen e nuses nga prindërit, gjithashtu e përshkojnë këngë që janë prekëse dhe nënçmuese për prindërit e saj.

Nismu moj lulie, nisu Naile  
Un jam nisun ballin teledisun  
Sun e la moj nanën vet  
Merre nanën tane  
Përplase për dheje  
Yp në limuzin lulie, ajde ke ne

(Ibrahimi 2003:85 - Cërnilishtë).

Nisu moj lule nisu  
Se jen tu nisun ene kruqit  
Unë jam e nisme Ballin teledisme  
Skam qish ti boj mori nanës teme

(Akhije Saliu 2013 - Zhitoshë).

Në rast se ndodhë ndonjë mosmarrëveshje, për shumë gjëra objektive dhe subjektive mes familjes së djalit dhe të vajzës, atë ditë në shtëpinë e djalit e ndjejnë njëfarë frike të përzier në ndenjë gëzimi. Andaj, edhe në të shkuar, edhe në të kthyer zgjidhen dy lajmëtar

(nishanxhi), të cilët ndahen nga krushqit, dhe para të gjithëve e lajmërojnë dhëndërrin se gjithçka është në rregull.

Pasi të zbresin të gjitha gratë prej qerres me nusen mbetet vetëm një grua. Pas pak vjen babai i djalit, apo vëllai më i madh dhe e zbresin nusën për dore deri te pragu i derës së mudbakut. Para se të zbres prej qeres, në tokë i shtrojnë tepsi e përmbi atë lëkurë. Mbi mbulesën e nuses i vehet freri i kuajve (si shenjë se prej tash nusja është nën kontroll të kësaj shtëpie), frerin e tërheq ndonjë voglush, kryesisht nipi. Përmbi krye i vehen 3 kuleq dhe kurani. Krejt kjo simbolizon: disiplinën, bereqetin dhe besimin në fe, që duhet t'i plotësojë nusja në shtëpinë e re. Kështu e qojnë deri te dera e mudbakut. Me këtë rast vajzat këndojnë:

Oj e broj kush na garkoj  
Baba xhypi na garkoj  
Jago baba na shkarkoj

(Ibrahimi 2003:86 - Cërnilishtë).

Edhe me këtë rast bëhet lavdërimi i shtëpisë së burrit, si në vargjet e poshtëshënuara:

Dole nause dole, pi asaj kasolle  
Erdhe nause erdhe ke sarajet tona  
Gjiete nause gjiete gjalin pa musteqe

(Ibrahimi 2003:86 - Cërnilishtë).

Në fshatin Zhitoshë shënuam edhe variantin:

Dole nuse dole pi asaj kasolle  
Hyne nuse hyne ke saraja tone  
Gjete nuse gjete djalin me musteqe  
At e deshe at e more at e more mëj  
Me shkollë o me fakulltete.

(Akhije Saliu 2013 - Zhitoshë).

Varianti i ngjajshëm këndohet edhe në fshatin Presill :

Dole nuse dole prej asaj kasolle  
Yne nuse yne ke saraja jone  
Gjete nuse gjete gjalin pa musteqe

(Zeqiri, 2010:2- Presill)

Këtu na del në shesh se vajza që e kanë zënë për djalë është nga një derë më e varfër, gjë që tregon edhe sot e kësaj ditë për një ndasi klasore, por jo në atë kuptimin e plotë që ka pasur dikur, sepse në dallgë kohësh kjo ndasi ka filluar të asimilohet.

Kur mbrin te mudbaku, ndalet para derës dhe me njërin gisht e lyen tri herë derën me mjaltë, kurse vajzat këndojnë:

Lyje derën me mijalte oj nuse  
Kaur de qieliqish ne t'kërsase, oj Lulie  
Asmit tona ne t'plasin, oj nuse

(Ibrahimi 2003:86- Cërnilishtë).

Kyr hynë brenda në mudbak, atë e njohtojnë me mjetet me të cilët do të duhet të punojë në të ardhmen. Herën e parë e qojnë te oxhaku dhe tri herë i këndojnë: oxhake - buxhake, kurse nusja tri herë i bie me krye oxhakut. Më pas nusen e qojnë te shporetin në të cilën zihet jemku, ku nusja i shtinë kripë. Më pas atë e qojnë te maxhja, duke mshelur dhe çelur tri herë, ndërsa të pranishmit i këndojnë:

Çile maxhen, ne t'kërsase oj nuse  
Nane jote, ne t'plase oj lule

(Ibrahimi 2003:87 - Cërnilishtë).

Pastaj, si rezultat i respektimit, nusja i përkulet vjehrrës tri herë në prehër, edhe atë me gjunjë. Vajzat tri herë këndojnë vargjet:

Unxhu grau nusie  
Për atrin e vjerës-o

(Ibrahimi 2003:87 - Cërnilishtë).

Në fund, nuses te preni i vehet një djalë të vogël, ndërsa ajo i jep një dhuratë.

Në mëngjes, të rinjtë zgjohen herët. Më pas hyjnë prindërit dhe më të afërmit, duke kënduar me daire vallzojnë. Në valle prindërit vallëzojnë herë me djalin e herë me nusen. Me këtë rast këndohet:

Trenafili n'faunt kataunit  
O sa ernet paska çelun

Un kam çelun kam jeshue  
Oborrin e Jago babës  
Odën o mori e Dylber agës

(Ibrahimi 2003:87 - Cërnilishtë).

Këto këngë, zakonisht i këndojnë vajzat më të rritura, por edhe gratë. Interpretimin e tyre e bëjnë në grupe dhe gjithmonë të përcjellura me dajre. Mund të themi se këto këngë janë aq të larmishme, sa që me shembujt e tyre të nduarnduarta paraqesin një kolorit të pasur si nga përshkrimi ashtu edhe nga forma dhe përmbajtja.

## **KLASIFIKIMI I KËNGËVE**

### **Këngë fejese**

Pjergullo o mori pjergullo

Pjergullo mori pjergullo

Me rrushin i dierdhun-o

Kush të ka mliedhun-o

Ai djali me bufkën e dierdhun-o

Pjergullo mori pjergullo

Me gjethet e derdhun-o

Ai vajza e Alldanqes

Me atë djalin me bufkën e derdhun-o

### **Këngë kur merret nusja në shtëpin e dhëndërit**

#### **Tërnafile**

Tërnafile rrena rrena

Ajo cauca u nodh mrena

Merre lulen shteje në xhi

Të dale në komshi

Ti thuen lumja ti

Kush ti vari këto flori

### **Këngë kur merret rizja**

#### **Fllanxa napër lam**

Fodulli i atit djalit as njeri se ban

As njeri se ban bufkën me një an

Drejtoje bufkën djal-o se mi more mend

Mori e drejtova po smë kishte hije

Lulie moi gojë kutie

### **Këngë e kënas**

#### **Top sheqer**

Top sheqeri i vogël-o

Ku mke qen i vetëm-o

Unë isha me nanën-o  
Tuj qendis gjergjefin-o  
Tja qoj atit djalit-o

### **Këngë fejese**

#### **Ke porta e madhe**

Ke porta e madhe shumë terma  
Ka përcejti dylber aga ene më pa  
Kur të pa bi-o qish të tha  
E çiti peslirën en ma dha  
Ke porta e vogël shadërvan  
Kapërcejti dylber begu ene më pa  
Kur të pa çish të dha  
E çiti unazën ene ma dha

### **Këngë kur priten petkaxhit**

#### **Mali bubullonte**

Mali bubullonte fusha jeshilonte  
Ai djali më kërkonte  
Çke moi nane ti me mu  
Unë djalin vet e du

#### **Informatori**

**Nerdegjyl Sejдини e lindur në vitin 1954 në fsh Nerovë profesioni Amvise**

### **Këngë kur cohen petkat**

#### **Moi syzezë**

Moi syzezë moi vetull kaleshkë  
Gjysma e Zhitoshes për ty ishte nezë  
Moi si u nozë zjari i rand  
Unë atë djalin çmoti e kam dasht  
I kam bo një çevre sallde me tel  
Të ma baje ner sa të jetë beqar

### **Kënga e kënas**

#### **Oda me tavan**

Oda me tavan Atixhe tët vnojm një alltan  
Alltanin se du, edu edu unë atë djalin  
Se është djal me shkoll

### **Kënga kur e marin nusen në shtëpin e dhëndërit**

#### **Lye derën me mjalte**

Lye derën me mjalte oi nuse  
Kur te çelish net kërsase oi nuse

### **Informatori:**

#### **Fatime Arifi e lindur ne vitin 1945 në fsh Presill profesioni Amvise**

### **Këngë kur i presin petkat**

#### **Ka shku vllau jone**

Ka shku vllau jone ka shku në Elbasan  
I ka than Atixhja blema një fustane  
O unë fustanin jalla ta kam ble  
O se ju bone nanës teme reje  
Ka shku vllau jone ka shkue në Gjermanie  
I ka than Atixhja blemi këto dymie  
O unë dymiat jalla ti kam ble  
O se ju bone babës teme reje

### **Kënga e ditës së dasmës**

#### **Thojshin e thojshin**

Thojshin e thojshin Eminja nuk bon  
Kur na hyni mrena era jorgovan  
Jorgovani çeli, çeli jorgovan  
Gojat e dushmanve va msheli

### **Kënga e vajit të qikës**

#### **Gjyle moi**

Gjyle moi dil ke vija  
Që të pret shoqnia, moi Gjyle sa e bukur je



Gjyle moi dil ke mani  
Se të pret jarani, moi Gjyle sa e bukur je

### **Kënga e largimit të vajzës nga shtëpia e nënës**

#### **Vishnja prej ranjës**

Vishnja prej ranjës daeshte  
Axheri pi nënës daeshte  
Qaje moi nane bijën-o  
Se ska kush ta mshie avlien-o

### **Këngë para fejesës**

#### **Pet përmi pet**

Pet përmi pet  
Cucat e Presejlles na lusin vet  
Pyet njona tjetrën a ka vend për mu  
Ka vend vend për mu, ka vend për ty  
Kemi vllaun e burrit djal për të martu

### **Këngë e vajit të qikës**

#### **Mos qaj lule Xhemile**

Mos qaj lule Xhemile se dot prishet bukuria  
Bukurien nauk e qaj e pash nanën u rob tu qajt  
Nanën jote de pajtojm dhe llokumin dot ja çojm

### **Këngë kur e marrin nusen**

#### **Dullaku i Atixhes kutia kutia**

Dullaku i Atixhes kutia kutia  
Mos kujtojsh Atixhe se dot lom ke shpia  
As ke shpia as ke nana  
Veç ke shpia e Dylber agës

### **Kënga e takimit të parë me vajzën**

#### **Në alltobuz**

Në alltobuz jam zatek ma pagujti një bilet  
Unë biletin sja pranova bukurin ja shikova

Unë i them se çke me mu  
Ai më thot se shumë të du

### **Kënga e vajit të çikës**

#### **Hanëm moi hanëm**

Hanëm moi hanëm ku e lave nanën  
Nanën e lash të reje me babën  
Hanëm moi hanëm ku e lave babën  
Babën e lash të ma rujnë vllaznia

### **Kënga e largimit të vajzës nga shtëpia e nënës**

#### **Hyn mrena dil përjashta**

Hyn mrena dil përjashta Fatimen se ka  
Fatime moi bijë çmu bone ti  
Nana të kërkonte ke veni ku flinje  
Ke oda ku rinje  
Ke obori ku mshinje

#### **Kënga e nusërimit**

##### **Kush foli u maru**

Kush foli u maru Salim aga u martu  
Gajlen ton e banjim bukën e vet e hanjim

### **Kënga e largimit të krushqive**

#### **Fatimja e nanës**

Fatimja e nanës, nanën e harrove  
O sa mirë ja bone Beqirin e more  
Këngë kur përqeshet babai i nuses

#### **Tringlloi legeni**

Tringlloi legeni vjen Lito çeni  
Lefti zagari ne tham kozari  
Nuk qenka kozari qenka Lito magari

### **Kënga kur përqeshet nëna e nuses**

#### **Hajde ke ne**

Merre nanën jote

Përplase përdhe

Hyp në limuzin ajde ke ne

### **Këngë fejese**

Hypa terma malit

Hypa termo malit, zrypa teposht zallit

Nëpër degët e ait

Shtiva me çish gjeta

E godita syzezën, syzezën ku më bonte çorapë

Godita syzezën napër flet të pëllumbit-o

**Informatori:**

**Kadrie Izeri**

**Nezja Aliu**

### **Shpeja jon e lyme o me orosan**

Shpeja jon e lyme o me orosan

Te marim Lulien vetllat si gajtan

Shpeja jon e lyme o sa bukuri

Te marim Lulien me këto gjemt e ri

Ta çojm në shtëpi of aman aman

### **Nji bafqe me portokalla me limona mrena**

Nji bafqe me portokalla me limona mrena

Babës të atit djalit ju gëzua zemra

Ju gëzua zemra ju gëzofit përher

Shyqyr që ka njeftur për birin e vet

Nji bafqe me portokalla me limona mrena

Nanës të atit djalit ju gëzua zemra

Një bafqe me portokalla me limona mrena

Motrës të atit djalit ju gëzua zemra

Ju gëzua zemra ju gëzofit përher

Shyqyr që ka njeft për vëllaun e vet

### **Bie shi bie vdor**

Bie shi, bie vdor

Ke obori i Rexhep agës  
Mori nauk osht shi nuk osht vdor  
Janë këto kruqit e Rexhep agës  
Dil be babo shtieri mrena  
Ce kan ardh mem marë mu

**Informatori: Barije Saliu e lindur në vitin 15.05.1949 profesioni Amvise**

**Ajde djalo i ri nama besën-o**

Ajde djalo i ri nama besën-o  
Të shkojm te kërkojm vetull zezën-o  
Vetull zezën nuk nai ipte baba-o  
Mere me të ik mere me inat  
Imi famili e madhe sun na bojn azgjo  
Ajde djalo i ri nama besën-o  
Të shkojm te kërkojm vetull zezën-o  
Vetull zezën nuk naj ipte nana-o  
Mere me të ik pike loma-o

**Vjen moi nane mollaxhiu, molla po na shet**

Vjen mollaxhiu molla me na shit  
Vet jemi molla vet jemi të holla  
Shporu be kopil sa nai more ment  
Vjen moi nane dardhaxhiu dardha me na shit  
Vet jemi dardha vet jemi të bardha  
Shporu be kopil se mi lujte ment  
Vjen moi nane pjeshkaxhiu pjeshka me na shit  
Vet jemi pjeshka vet jemi kaleshka  
Shporu pizdevenk se mi lujte ment

**Informatori: Mirem Saliu e lindur 01.05.1969 profesioni Amvise në fsh.Zhitoshe**

**A tët ap moi bija ime**

A tët ap moi bija ime për një fukara  
Se dua baba ime se dua  
Atë e fkasim fukara mu dem çue pa para  
Se dua baba ime se dua  
A tët ap moi bija ime për një katunar

Se dua baba ime se dua  
Atë e fkasin katunar mu dem çue me magar  
A tët ap moi bija ime për një gjal i ri  
E dua baba ime e dua  
Atë e fkasin djal i ri mu dem çue me flori  
A tët ap moi bija ime për një amerikan  
E dua baba ime e dua  
Atë e fkasin amerikan mu dem çue me ajroplan

### **Moi Lulie**

Moi Lulie moi Lulie  
Me gjergjefin jak të rime  
Ene nët paft Lulie baba thuj se mlodha një grusht me thana  
Oj Lulie moi Lulie  
Mer gjergjefin jak të rime  
Unë po vit po spom len baba  
Thuj se mlodha një dor me dardha

**Informatori: Ava Sulejmani e lindur 06.07.1963 profesioni Amvise fsh-Borinë**

### **Hypa në mollë**

Hypa në mollë e pash bel hollën  
Drit i lishonte balli  
Çish i thoshte djali  
Larg e pash o me dor ja bona  
Hajde moi bijë ke nana

### **Bijen tri daire moi nanë**

Bijen tri daire moi nanë të trija me dor  
A se din mori nana ime, se unë nesër shkoj  
Edhe në shkofsh të qoftë udha e mar moi bijë  
Tu bezdis gjergjefi tu mu bo çorap  
Çajo dele e huaj moi bijë  
Fmijët shum e rokin  
Se ti e din të lumja moi bijë  
Ti dot rish në tokë dhe cullve të djepit du bojsh temena

Kur do vish ke nana  
Do rish si mikesh  
Kur dot hajet buk ke manxhja sun gjesh  
Kur dot pijet ujë, shtamën sun e gresh  
Llafet sti haroj moi nanë deri sa të jem gjallë

**Informatori: Rabije Ajrullai e lindur 11.02.1956 profesioni Amvise fsh-Bellushin**

### **O për hajr**

O për hajr o me të marë  
More djal, çish nai bone kjet dasëm  
More djalë  
Po e gëzove nanën e babën  
Ene farefeysin  
O ky dhandri me pare more djalë  
O arë o gurbetçar more djalë

### **O ki deti ova ova**

O ki deti ova ova thot Azizja nane shkova  
Qaj moi nane mos pusho  
Se Azizen de kërkosh  
O ki deti ova ova thot Azizja babe shkova  
Qaj morë babe mos pusho se Azizen de kërkosh  
Shum punova, shumë qendisa  
Gjalit të agës ja çova

**Informatori: Atixhe Memedoska e lindur 13.07.1960 profesioni Amvise fsh-Sazhdevë**

### **Ani tej moi cuc**

Ani tej moi cuc me atë kmish basme  
Mos dil në avlli se zemrën ma plase  
Ani tej moi cuc me ato sey të zi  
Aq shumë ije të paskan  
Mos fillo dashnin mos fillo dashnin  
Moi se duhet ta majsh besën  
Kur ta japësh duhet të shkosh  
Unë besën ja kom dhan

Tash ja jap dhe dorën  
Ne të dy kemi me u mar sa të mbaroj shkollën

### **O moi e mira**

O moi e mira napër fera  
Tlutem tlutem sa erdh vera  
Mirat agën shumë e desha  
Vet e desha vet e mora  
Plasni shoqe për okoll

### **Dikush e ka qesh Barijen**

Dikush e ka qesh Barijen dikush e ka qa  
Ka thon vllau i jon nanë vet unë e kam pa  
E kom pa unë vet menen ma ka mush  
I ka vetllat e holla si rrush

### **Moi e mejra me syt e zi**

Moi e mejra me syt e zi  
Dot ta vras moi qenin ty  
Not e dit lef në çat avllej  
Moma vrejt be gjalo  
Hajde mrom ke mu në shpej  
Kom lidh qenin me sinxhejr  
Ka shku nana gjal në miqsej  
Baba në Pazar porta qel dera pa dry

**Informatori: Ilmije Mehmeti e lindur 09.01.1937 profesioni Amvise fsh-Zhitoshë**

### **8.Këngët e vajit të çikës**

Mos qaj lule se dët prishet  
Bukurija, bukurijën  
Nuk e qaj e pash  
Nanën u rop tu qajt  
Nanën jote de pajtoim  
Dhe llokumin do tja çoim

### **9.Këngët e ditës së dasmës**

Dullaku i lulijës kutija  
Kutija mos kujtosh  
Lulije se dët loim  
Ke shpija, as te  
Shpija, as te nana  
Por te ai djali.

### **10.Këngët e krushqive**

Dil lulije dil të ura  
Vim e tmarim me  
Shum vetura do  
Me gra e do me  
Bura autobuzi me  
Shum flamura  
Dy flamura si  
Pranoina se  
Lulija është  
E jona.

#### **a) Këngët kur arrijnë krushqit në shtëpinë e nuses**

Nisu moj lule sem  
tu nisun edhe krushqit  
Unë jam e nisme  
Ball teledisme skam  
Qish ti boj mori nanës  
Teme.

#### **b) Këngët e burrave (përqeshen nëna dhe babai i nuses)**

Tringlloj legeni vjen  
Lito qeni, lefti zagari  
Ne tham Kozari nauk  
Qenka kozari qenka Lito  
Zagari.



**c). Këngët e nusërimit:**

Ec nuse lule kadal kadal  
Ec ka nji kam e bon temena  
Lum gjali jon që të ka mar.

**Ç). Këngët e largimit (nisjes) të krushqive**

Dole nuse dole pi asaj kasolle  
Hyne nuse hyne ke saraja tone  
Gjete nuse gjete djalin me musteqe  
At e deshe at e more at e more mëj  
Me shkollë o me fakulltete.

**d). Këngët e kthyerjes së krushqive**

Va morëm lulen va lam ferat  
Ti kullose baba i lules derrat.

**11.Këngët e sofrës**

**12. Këngë për nusen, kur ia nis punëve të shtëpisë**

Tu zemrua vjera o  
Me goj stë flet se  
Si bohet punët se su  
Grita shpejt se si bona  
Kafe kafe me izmet.

**13.Këngët shpëtitëse**

Gjemt e Zhitoshes si  
Si simit pazari gjemt e  
Llazhanit si bagla magari.

Kreu i tretë

**NINULLAT**

## Ninullat

1

Nani nani zogë shullani

Pishi pishi zogë fildishi

Luli luli të ma zane gjumi

2

Nani-nani Luli

Caucën tem te more gjumi

Të bëhesh si një lule në pranverë

Tu boft seyni si filxhan

Tu boft gusha për merak

Tu boft shtati për merak

3

Nani-nani Luli

Të ma zane gjalin xhumi

Xhumi i amël gojën plot me tamël

Të rejtet sa një veç

Veçti sa një ka

Tej të bohesh ner në tra

4

Nina nina djali oo

Për gjumë pëllumbin oo

Përkund natën e përkund

Diten, që të më ritesh për

Çdo dit të rit nëna ty asgan

Që ti ngjajsh stërgjyshit tend.

Informatori:

Kadrie Izeri e lindur në vitin 1945 në fsh Nerovë profesioni Amvise

Barie Saliu e lindur në vitin 1953 në fsh Zhitoshe profesioni Amvise

Mbledhës: AXHije Saliu      Data:2020

6.

Nani nani dobardani  
fli se nana te don shum  
Ti mu ritsh o nafak lum  
Nafak lum o gjal I ri  
Djelli ty gjidh dit met pa  
Kur de ritesh ghali im  
Ti o bir de me dalish trim

7.

Nani nani dobardani  
Fli fli o biri im  
Jo bofsh nanes ti trim  
Te con nena ty ne shkoll  
Qe te msojsh ne fakulltet  
Qe mos shkojsh ne kurbet  
Si baba si ron  
Neper udha flen  
Nani nani dobardani  
Fli fli o biri im

8.

nani nani te zant gjumi  
nani nani te zant gjumi  
nani nani te zant ne gjep  
te ka nana zog me flet  
nani nani dobardani  
ligat ne ti mar uji  
ti o uj ti o det  
te ka nana zog xheneti

9.

nani nani te perkun mami  
te perkun ne gjep pi zllato

nani nani te qis ka dera  
po kam fruk se mot mar era  
nani nani dobardani  
tash tet qis ke mani  
po kam fryk mot mar murani  
nani nani dobardani  
ti u ritsh si plep i gjate

**10.**

nani nani cuc e nanes  
mori cuc mori flori  
u bofish si lule per jeshi  
ti ritesh nenes e madhe si asllan  
tu boft shtati si bajrak  
fli moj cuc mylli syt  
kur ti apish te me shovish mu  
ti apish si xixat ene si anca  
ty te risin baba ene nana

**11.**

nani nani dobardani  
vjen yseni ene asani  
te shon ket bir si asllani  
keto faqe si moll  
per ti gushur sa me mir  
nani nani dobardani  
u rit gjali si tarzani.

Sefide Zeqiri , 75 vjeçare, shkollë 4 -vjeçare nga fshati Presill.

Mbledhës: Emir Zeqiri      Data: 2011

Kreu i katërt

# LOJËRAT POPULLORE

Lojërat popullore të fëmijëve zënë një vend të rëndësishëm në fushën e folklorit tonë aq të pasur dhe konsiderohen si gurrë të pashtershme të saj. Lojërat janë komponentë të rëndësishme për edukimin e fëmijëve shkollorë, të cilët, krahas edukimit fizik që e realizojnë nëpërmjet programeve shkollore, janë edhe lojërat popullore të trashëguara nga e kaluara. Fëmijët qysh moti, kanë ditur të dëfrehen si ta shfrytëzojnë kohën e lirë, për t'u edukuar dhe aftësuar fizikisht dhe psikikisht në jetën e përditshme. Nëpërmjet lojës zhvillohet shkathtësia, zhdërvjelltësia, shpejtësia, gjindshmëria, vëmendja, kujtesa të menduarit dhe fantazia. Në lojë fëmija bëhet rezistues dhe i disiplinuar. Formohen shprehi për të përkrahur shokun, për t'i respektuar rregullat e kolektivit.

Fëmijët më së tepërmi luajnë në pranverë dhe në natyrë, por edhe në stinët e tjera të vitit. Gjatë dimrit disa lojëra luhen në ambiente të mbyllura. Në shumë raste lojërat e fëmijëve luhen së bashku nga të dy gjinitë, megjithatë ekziston ndarja e lojërave sipas moshës e gjinisë.

Disa nga lojërat kanë humbur, janë harruar dhe nuk luhen më, por disa i hasim në rrethe të ndryshme, ku luhen lojëra me karakter gati të njëjtë, por në forma të tjera, ku në bazë të të folmeve kanë marrë edhe emërtimet përkatëse.

Në krahinën e Pelagonisë lojërat popullore janë të shumta, të trashëguara brez pas brezi. Gati çdo fshat ka lojërat e veta. Andaj lojërat në Cërnilishtë dhe në fshatrat tjera shqiptare të Prilepit, Krushevës, Manastirit, por edhe Velesit etj., siç janë: Desova, Zhitosha, Alldançja, Nerova, Presilla, Kishava, Jabollçishtja etj., paraqesin një oazë të kulturës materiale e shpirtërore shqiptare. Disa nga lojërat i gjejmë edhe në fshatra të tjera, disa prej tyre mbajnë emra të ndryshëm e disa emërtohen njësoj. Megjithatë shumë nga lojërat e krahinës së Pellagonisë luhen vetëm aty. Të gjitha këto lojëra që luhen në këta fshatra kanë emrat e tyre. Këtu i kemi trajtuar këto lojëra: kliska, koso pietle, bzzz., llozhan, petkamena (pesëgurëshi), ksul peshtalov, çiska, dollgomagaric, dunja, kërtaq, kukumizha, ashaik, buçain, gollan, ane, ruda, bishk, me karia, shkonte miza çore, anko, fili-fili, mija-mija kollcevore, pirlle, gërshan, bat-bat etj. (Ibrahimi 2003:41-42)

### Loja tokmonok

Në këtë lojë kanë luajtur një grup njerëzish, në fillim bojmë një vizë fillestare nga ku do të fillojë secili lojëtarë të kërcej prej vendi në largësi të caktuar. Nëse dy lojëtarë kërcejnë largësin e njëjtë atëherë do të përsëritet loja deri sa të mbetet një fitues.

### Loja Xhilit

Këtë lojë e kanë luajtur në fshatin Nerovë komuna e Krushevës, për të luajtur këtë lojë lojëtarët kanë zgjedhur nga një shkop lejthije për arsye se shkopi i lejthijës është më i lehtë dhe më larg gjuhet. Në fillim të lojës bëhet një vizë fillestare nga ku secili lojëtar gjuan me shkopin e vet, ai i cili do të gjuaj më larg është fitues i lojës.

### Loja trenak

Këtë lojë e kanë luajtur në fshatin Nerovë komuna e Krushevës, në këtë lojë kanë marrë pjesë një grup i caktuar njerëzish, në fillim kanë hequr një vijë fillestare dhe një person i cili do t'i komandonte për fillimin e lojës, në momentin kur do të jenë lojëtarët gati përgjegjësi i lojës ose Komandanti me goditjen e shuplakave tregon fillimin e lojës, lojëtarët fillojnë kërcimin me një këmb deri në vendin e caktuar nga ana e Komanduesit.

Ai i cili arrin i pari në vendin e caktuar atëherë ai është fitues i lojës dhe shpërblehet me ndonjë send.

### Loja pare me var

Këtë lojë e kanë luajtur disa lojëtarë. Në fillim kanë bërë dy viza të gjata prej të cilave njëra do të jetë viza fillestare ndërsa tjetra do të jetë caku nga ku do të hedhet parja prej metali, secili lojëtarë hedh veç e veç në vizën e caktuar. Ai i cili do të hedhë në vizë është fitues dhe i grumbullon monedhat prej metali e tjerëve dhe konsiderohet si fitues loje.

## **LOJA E FILXHANAVE**

Kjo lojë bëhet në odë burrash dhe e luajnë burrat duke shkuar në muhabet te njëri-tjetri.

Burrat ndahen në dy grupe pastaj marrin një tepsi me dhjetë filxhana të njejtë. Tek ato dhjetë filxhanë fshihet një unazë duke i përmbysur filxhanat që mos të duket unaza. Njëri grup merr tepsinë me filxhanë dhe e fsheh unazën duke dalur jashtë odës. E sjellë tepsinë në odë dhe e vendos përpara grupit kundërshtar, ndërsa përgjegjësi i grupit duhet të zbuloj unazën duke i ngritur filxhanët një nga një në mënyrë normale përveç filxhanit të unazës.

Personi që i ngren filxhanat për filxhanin në të cilin mendon se fshihet unaza gjatë ngritjes së filxhanit duhet të thotë fjalën „ Versën “ duke e ngre zhag nëpër tepsi filxhanin për të tingëlluar unaza.

Nëse e zbulon në këtë mënyrë unazën e fiton grupi të drejtën për ta fshehur unazën. Nëse e zbulon unazën pa e thënë fjalën Versë duke e ngritur në mënyrë normale filxhanin, atëherë prap e fsheh unazën grupi i njejtë.

Loja e filxhanave zgjat 11 të fshehura të filixhanave. Grupi fitues llogaritet ai që fiton 6 të fshehura pa e gjetë unazën.



Grupi fitues i merr dy pjata dhe jashtë odës e nxin njëren pjatë dheu me tym të kadilit. Pjatën e zizuar ia jep burrit nga grupi humbës që e cakton vetë grupi, ndërsa pjatën e pastërt e merr njëri nga grupi fitues. Pjatat i mbajnë në duar përmbys duke mos u parë ana e zezë e pjatës. Pala humbëse detyrohet t'i bëj lëvizjet e njëjta me duar nën pjatë si pala fituese duke e shikuar në sy palën fituese duke mos e hetuar vehten se e nxin fytyrën.

Të gjithë pjesëmarrësit në odë qeshin në këtë rast. Në fund i japin një pasqyrë personit të nxirë që ta shohë fytyrën e vet.

**Informator: Adnan Mehmeti  
f. Zhitoshe 1961**

### **LOJA E „BATIT“**

Është një lojë burrash që luhet në odë burrash pas darke duke qenë në muhabet. Në muhabet shkohet te shtëpia ku ndodhet ndonjë musafir i ardhur. Kjo lojë zhvillohet duke u ulur në formë rrethi burrat në mes të odës.

Qëndrimi i burrave është ulur duke i vendosur këmbët përpara të thyme në gjunjë. Hapësira në mes të rrethit është aq sa të qëndroj vetëm një njeri i ulur në gjunjë.

I zoti i shtëpisë siguron një shervete të cilën e lagim me ujë dhe e përdredhim si një bisht (bistek) i flokës i gjatë dikund rreth 30 cm. Kjo shervete (shami) e dredhur quhej „Bat“.

Një person ulet në mes të rrethit në gjunj. Personi që ulet në mes të rrethit caktohet me short. Loja fillon duke e goditur shpinës me shervete personin që është në mes. Burri që është në mes duhet ta kap dhe ta merr sherveten nga personi që ka sjell ose personat e tjerë. Shervetja qarkullon dorë më dorë ndër këmbë në rreth të mbyllur duke mos i lënë hapësirë që ta kap burri i mesit. Burri në mes goditet gjithmonë pas shpine duke bërtitur, „Bat, bat, bat“ me këto fjalë e habisin personin e mesit që mos ta gjejë sherveten. Shervetja qarkullon gjithmonë ndër këmbë duke e ngushtuar hapësirën ndërmjet këmbëve që të mos mund ta shohë personi i mesit.

Atij që i merret shervetja nga dora ulet në mes për ta zëvendësuar atë. Gjatësia e kohës së qëndrimit në mes të rrethit varet nga zgjuarsia dhe shkathtësia e tij.

Loja zgjat deri sa të lodhen burrat.

**Informator: Adnan Mehmeti  
f. Zhitoshe 1961**

## **LOJA “ZU U U U “**

Kjo lojë është një lojë burrash që luhet në këmbë në odë ose jashtë. Loja zhvillohet në këtë mënyrë:

Burrat qëndrojnë në rreth dhe një burrë qëndron në mes të rrethit. Personin e mesit e përcaktojnë ose me short ose paraqitet ndonjëri vetë si vullnetar. Ai duhet të mbajë këtë qëndrim:

Njëren dorë e vendos nën sqetullën e tjetrës duke e kthyer anën e pëllëmbës nga jashtë me gishtërinjë të kthyer nga lart. Ndërsa me dorën tjetër i mbulon sytë.

Pasi lojtari i mesit merr këtë pozicion fillon loja duke bërëtitur Zu u u u... dhe njëkohësisht duke e goditur njëri nga lojtarët me shuplakën e tij mbi shuplakën e lojtarit të mesit. Lojtari i mesit duhet ta gjej se kush nga burrat e ka qëlluar duke ia drejtuar gishtin tregues në drejtim të tij ose duke e prekur me dorë atë. Nëse nuk e gjen se kush e godet loja vazhdon deri sa ta gjejë atë. Nëse e gjen atë që e godet, atëherë ai hyn në mes për ta zëvendësuar atë.

Duhet të cekim se vetëm një burrë ka të drejtë të sjellë me shuplakë e jo dy ose tre përnjëherë ose dy një pas një. Pasi goditet njëherë ai i zbulon sytë dhe kërkon goditësin. Para secilës goditjeje fillon zhurma duke bërë zu u u u..... dhe atëherë fillon pozicionimi i lojtarëve duke u marrën vesh me isharet se kush do ta godas dhe pas goditjes bëhet ndërrimi i pozicioneve.

Zhurma që krijohet para, gjatë dhe pas goditjes ia pamundëson lojtarit të mesit që ta gjej goditësin.

Emrin „Zu u u u.....” kjo lojë e ka marr nga zhurma që bëhet gjatë lojës.

Loja zgjatë deri sa lodhen lojtarët ose deri sa u bezdiset atyre.

**Informator: Adnan Mehmeti**

**f. Zhitoshe 1961**

## **„LOJA E UNAZËS”**

Loja e unazës luhet nga burrat dhe djemtë në odë burrash.

Edhe kjo lojë zhvillohet nëpër oda zakonisht pas darke duke shkuar në muhabet te njëri-tjetri. Njëri nga pjesëmarrësit në odë propozon lojën dhe nëse e miratojnë shumica e të pranishmive bëhen përgaditjet e lojës.

Pasi pihet kafja ose çaji, një i ri i shtëpisë nikoqire e merr një shami ose shervete e lag me ujë dhe e përdredhë dhe e bën dy fije deri sa të marrë formën e një bisteku (sikur bishti i flokëve të një vajze). Dy këndet e holla lidhen ndërmjet veti që të mos shpërdridhet shamia.

Burrat ulen këmbëkryq ose në gjunjë në rreth përgjatë mureve të odës. Nga të pranishmit sigurohet një unazë që do të hynte në lojë.

Pasi bëhen gati shamia dhe unaza përcaktohet burri me short që do ta fsheh unazën.

Burri që fsheh unazën e merr atë në grusht dhe fillon ta fshehë duke filluar nga njëra anë që nga i pari deri te burri i fundit. Çdo person që merr pjesë në lojë i hap të dy pëllëmbët e duarve për të pranuar unazën.

Lojtari me unazë pasi i kalon të gjithë burrat dikund e ka lënë unazën. Pasi mbaron me të fshehurën i drejtohet të parit me pyetjen: Ku është unaza?

Para se të thotë emrin e personit ku mendon se fshihet unaza e shtrin njërin dorë duke e hapur pëllëmbën. Burri që e ka fshehur unazën e godet me sherveten dorës dhe ai e tregon emrin se ku fshihet unaza. Burri me sherveten i drejtohet personit të përmendur duke i thënë shtrijs dorën dhe trego: Ku është unaza?

Në të njejtën kohë kur e pyet e bën edhe goditjen me shervete dorës. Pasi mendohet pak e thotë emrin e burrit ku mendon se fshihet unaza. Personi me shervete i drejtohet edhe këtij në të njejtën mënyrë duke e goditur dhe pyetur për unazën. Burri që e gjen unazën i jepet atij e drejta ta fsheh unazën, por së pari duhet ta shtrij dorën të pranojë unazë bashkë me një goditje dorës duke i thënë: Ta shita unazën!

Loja zgjat deri sa të lodhen burrat.

## **LOJA E „BISHKËS” OSE E „GUXHËS”**

Kjo lojë është e djemëve. Zakonisht luhet në fushë të hapur. Kjo lojë zakonisht luhej nga loparët që i kullosnin lopët në fushë, por edhe nga fëmijë të tjerë. Loja zhvillohej në këtë mënyrë :

Së pari formohej grupi i lojtarëve, i cili mund të përbëhej prej 5,6,7 ose më shumë lojtarësh. Njëri prej tyre e bënte gati Bishkën. Bishka është një copë druri me diametër 4 deri 5 cm që ka formë kubi ose cilindri.

Lojtarët tjerë i bëjnë gati gropat. Nëse janë në lojë 6 veta, atëherë bëhen 5 gropa në formë rrethi me thellësi prej 3-4cm dhe diametër 10 cm.

Gropat vendosen në një rreth të caktuar dhe me një distancë nga gropa në gropë prej 2 metrash. Në mes të këtij rrethi të gropave bëhet një gropë pak më e madhe se ato të tjerat me diametër prej 15 cm dhe e thellë 10 cm. Kjo gropë quhej gropa e bishkës. Largësia e gropës së mesit nga gropat tjera është 2 m. Çdo lojtarë ka nga një gropë të veten që e ruan me njërin këmbë duke e vendosur mbi gropë. Ndërsa, djali që e gjuan bishkën nuk ka gropë.

Secili lojtar duhet të ketë nga një shkop në dorë, që shërben për goditjen e bishkës. Shkopi duhet të jetë i drejtë me një gjatësi 1,2 m deri në 1,5 m dhe me trashësi prej 2 cm. Djali që e gjuan bishkën me dorë përcaktohet me short ose në bazë vullnetare.

Të gjithë lojtarët mbajnë pozicionet e veta me njëren këmbë mbi gropën e vet dhe me njëren anë të shkopit mbi gropën e mesit, me çka i pamundësohet djalit me bishkën që të mos mundet ta fus bishkën në gropën e mesit.

Bishka gjuhet me dorë në drejtim të gropës së mesit prej një largësie prej 5 – 6 m. Lojtarët kanë të drejtë ta godasin bishkën edhe në ajër duke fluturuar, por edhe në tokë.

Lojtarët nuk kanë të drejtë ta nxjerrin bishkën nga gropa dhe kur ajo është e shkelur me këmbë nga bishkaxhiu. Nëse bishka ndodhet në një largësi më të madhe bishkaxhiu e gjuan dhe vrapon për ta shkelur atë para se ta godasin lojtarët e tjerë e pastaj prej aty e gjuan përsëri që më lehtë ta fus në gropë .

Në momentin kur bishka hyn në gropën e mesit lojtarët duhet t'i ndërojnë vendet e tyre duke lëvizur në drejtim të gropës më të afërt nga ana e djathtë, duke mbuluar gropën me këmbë. Bishkaxhiu në atë moment mundohet të shkelë ndonjë gropë me këmbë për të shpëtuar nga vrapimi pas bishkës.

Lojtari që mbetet pa shkelur (pa zënë) ndonjë gropë e merr rradhën për të vrapuar pas bishkës. Gjatë zhvillimit të kësaj loje lojtarët gjithmonë kanë kujdes që mos godasin me shkopinjë njëri-tjetrin, por edhe me bishkën.

Loja zgjat deri sa të lodhen lojtarët.

**Informator: Adnan Mehmeti  
f. Zhitoshe 1961**

### **„LOJA ME ASHIKË “**

Kjo lojë zhvillohet në shesh të katundit në një vend të rrafshit ku nuk pengohen kalimtarët.

Është një lojë e djemëve dhe burrave. Ashiku është një asht (koc) që merret nga gjunjtë e këmbëve të pasme të deleve ose deshve. Madhësia e ashikut është 3cm i gjatë 2cm i gjërë dhe 2cm i trashë.


Loja zhvillohet me 2,3,4,5,6 ose më shumë lojtarë. Për të hyrë në lojë çdo lojtarë duhet të ketë minimum një ashik dhe një konjak.

Konjaku është ashik më i madh se të tjerët që merret nga dashi i madh dhe shërben për të gjuajtur në drejtim të ashikëve. Konjaku është pak i gdhendur në qoshe për ta kapur më

mirë me gishtërinjë dhe në anën e gropës është mbushur me dyllë ose me zift (katran) për të qenë më i rëndë.

Kur loja luhet në akull në vend të konjakut mund të përdoret „Çyba”. Çyba është një lloj si ashiku, por vetëm që është më e madhe se ashiku dhe merret nga kafshët e mëdha si lopa, kau, mëshqerra ose viçi. Vizatimi i hapësirës ku luhen ashikë në akull është i njëjtë si ai në tokë (Dhe).

Ja si duket hapësira ku luhet loja me ashikë:



Hapësira ku vendosen ashikët është e gjatë diku rreth 3 m dhe e gjerë rreth 80 cm.

Çdo lojtarë vendosë në kolle nga një ose nga dy ashikë varësisht si merren veshit lojtarët.

Në vijën e mesit renditen ashikët. Hapësira brenda vijave quhet „Kolle”. Ashikët goditen nga ana e majtë ose nga ana e djathtë që do të thotë nga ana më e largët e kolles. Lojtari i parë që sjellë me konjak në drejtim të ashikëve përcaktohet me short. Në qoftë se lojtari godet një ashik por nuk e nxjerr jashtë kolles, ai ashik quhet „Migë”. Lojtari i parë nëse nuk e nxjerr ashikun përjashta kolles s`ka të drejtë të sjellë prap deri sa të rënditen të gjithë lojtarët me të sjellur. Lojtari i rradhës që sjell duhet ta godas vetëm ashikun Migë.

Nëse e godet atë dhe e nxjerr jashtë kolles atë e fiton e bën për vehte dhe pastaj sjellë me konjakun pas të tjerëve, por nga vendi ku është ndalur paraprakisht konjaku. Nëse prap godet ashik tjetër edhe atë e nxjerr jashtë kolles edhe atë e fiton sjell pas ashikëve të tjerë të mbetur deri sa të huqë, ose godet ashik por nuk e nxjerr jashtë kolles vazhdon lojtari që e ka rradhën pas tij.

Kështu renditen të gjithë lojtarët deri sa të ketë ashikë në kolle. Kur të nxirren të gjithë ashikët nga kollja fillon një lojë e re me ashikë të rij, por mundet edhe me lojtarë të ri nëse ndonjëri prej tyre tërhiqet.

Është e ndaluar që lojtari të shkelë vijën e kolles me këmbë. Nëse dikush e shkelë vijën e kolles atij nuk i quhet (i llogaritet) ajo e goditur, s`ka të drejtë të sjellë përsëri dhe ashiku kthehet në pozicionin e mëparshëm dhe vazhdon lojtari i rradhës. Nëse ndonjë lojtarë s`ka ashikë për të vendosur në kolle ai s`ka të drejtë të luaj. Ashikët shiteshin me para ose merreshin hua. Çmimi i ashikëve varej nga kërkesa e tregut prej 10 din. deri në 50 din për një ashik.

Ashikët i ruanim në strajcë (torbë) 20 ,30, 50 ose 100 copë e gjithë kjo varej nga mjeshtria e lojës.

Duhet të cekim se kjo lojë fillon të luhet nga muaji Nëntor dhe vazhdon deri në të muajit Prill. Pas kësaj kohe fshatarët i vendosnin ashikët në strajcë dhe i grinin në tavan të shtëpisë, sepse niste puna e tyre.

**Informator: Adnan Mehmeti  
f. Zhitoshe 1961**

### **LOJA „GURIN LINE” (GUR-LE )OSE „PIRLE”**

Kjo lojë është lojë fëmijësh. Luhet në lagjet e fshatit ku ka hapësirë të përshtatshme për të. Këtë lojë mund ta luajnë 4,5,6 ose më shumë lojtarë. Kjo lojë zhvillohet në këtë mënyrë:

Së pari sigurohet një gurë i madh me diametër 30-40 cm . Guri mund të ketë formë të rrumullakët ose të katrorit me një trashësi 8-10 cm , mjafton të jetë i rrafshat në anën e sipërme dhe të poshtme të tij.

Mbi këtë gurë të madh vendoset një gurë tjetër më të vogël që duhet të jetë i rumbullakët në formë topi me një madhësi 6-7 cm . Ky gurë quhet „Gur-le” ose „Pirle” . Çdo fëmijë ka gurin e vet me të cilin gjuan mbi Gurlen - Pirlen për ta rëzuar nga guri i madh.

Pasi vendoset guri i madh dhe gurle-ja hiqet një vijë e gjatë prej 3-4 m në një distancë 4-5 metra nga guri i madh.

Lojtarët përcaktojnë një nga rradhët e veta me short për të vrapuar pas Gur-les dhe për ta vendosur mbi gurin e madh kur lojtarët e tjerë ta rëzojnë atë. Fëmijët nga vija e përcaktuar gjuajnë me gurët e tyre në drejtim të Gurles. Nëse Gurlen e rëzojnë nga guri i madh të gjithë vrapojnë njëkohësisht për t'i marr gurët e vet. Ndërsa, djali që është përgjegjës për Gur-len e merr atë dhe sa më shpejt e vendos mbi gurin e madh. Mandej vrapon pas të tjerëve për të prekur ndonjë fëmijë para se të kaloj pas vijës.

Nëse asnjë lojtar nuk është prekur me dorë para vijës, atëherë loja vazhdon me gjuajtje të re nga vija. Në qoftë se është prekur me dorë ndonjë lojtar në zonën e ndaluar ndërmjet vijës dhe gurit, atëherë ai e zavendëson djalin që kujdeset për Gur-len.

Nëse ndonjë lojtar vonohet për ta marr gurin e vet dhe s'ja merr mendja se mund të arrijë ta marrë në kohën e duhur ai ka të drejtë që të pretë një rast tjetër të volitshëm kur Gur-leja nuk do të ndodhet në vendin e vet.

Lojtari që vendos Gur-len mbi gurin e madh nuk guxon të prekë me dorë asnjë lojtar përderisa Gur-leja është në tokë (përdhe).Gjatë kësaj loje fëmijët gjithmonë kanë kujdes që me gurët e tyre mos goditen me njëri-tjetrin.

Loja vazhdon deri sa fëmijët të ndjejnë lodhje ose deri sa t'i thërrasin në shtëpi për drekë ose për darkë.

## **Lojat për fëmijë**

### **Loja e bilijave**

Kjo lojë luheshte më shumë në fshatin Zhitoshe komuna e Dollnenit, në fillim të lojës duheshte të jenë 4 lojtar dhe pastaj bëheshte një grop (rreth) edhe një trekëndësh ku në trekëndëshin vendoseshin 3 monedha në të gjitha qoshet e trekëndëshit dhe pastaj bëheshte një viz e gjatë edhe të 4 lojtarët me anë të bilijave hudhnin bilijën dhe ajo bilij e cila ishte më afër vizës shutonte e para edhe te tjerët me radh secili nga afëria e vizës edhe pastaj në qoftëse bilija hynte në rrethin ose gropën atëherë kundërshtari nuk mundeshte të të eliminoj nga loja nëqoftëse je jashtë rrethit ose gropës atëherë nëse të godiste bilija të eliminonte. Nëse lojtari i parë kishte të drejtë të shutonte drejt trekëndëshit me monedha edhe atë nëse të ngelte bilija në trekëndëshin mbrenda atëherë eliminohesh vetë.

### **Loja Mishtatare**

Kjo lojë luhet në fshatin Zhitoshe komuna e Dollnenit, në këtë lojë marrin pjesë 10 ose 20 lojtarë edhe atë numrohet në fillim deri në numrin 10 ose 20 varësisht sa lojtar luajnë ose marrin pjesë edhe pastaj kujt i bjer numri 10 ose numri 20 ai numron d.m.th. numron me sy të mbyllura deri sa të fshihen lojtarët tjerë pastaj fillon loja e kërkimit edhe atë lojtar, i cili e gjen i parë ai e ka për të numruar dhe kështu vazhdon loja.

### **Lojrat për vajza**

#### **Loja Ciska**

Kjo lojë luhet me një plloçkë së pari e vizatojmë çiskën dhe e ndajmë në katër (4) pjesë, luhet me një këmb, me këmbën e djathtë shkon te secili katror me të kërcyer vetëm te katrori i tretë (3)mundesh të pushosh me të dy këmbët.

**Informatori:**

**Axhi Sami Izeri**

**I lindur më vitin 1944 fsh Nerovë profesioni Bujk**

**Informatori: Jusuf Saliu**

**I lindur në vitin 1956 në fsh Zhitoshe profesioni Bujk**

Kreu i pestë

**OJAT**



Dikur, në të kaluarën shqiptarët në përgjithësi detyrimisht disponuan nga një palë rrobash festive. Ato gjithnjë ishin të reja, të pastra, të zbukuruara në mënyrë speciale. Këmisha dhe fustane, poture dhe përparëse – ato ishin vetëm pjesë të rrobave të kyçura në sëndukët e zbukuruara. Në jetën e përditshme stërgjyshërit dhe stërgjyshet tona gjithashtu respektuan rregulla të rrepta për të ruajtur karakteristika lokale, që i bënin punimet e një krahine të dalloheshin nga ato të krahinave të tjera. Edhe në rajonin e Prilepit dhe Krushevës përdorehin gjerësisht tekstilet e leshta, të ekzekutuara me një varg teknikash të ndryshme pune.

Të tjera punëdore me interes, ishin thurjet e ndryshme me shtiza, ojat e dantelat e sidomos qendisjet e shumëllojshme, që nga qendisjet e thjeshta fshatare deri tek qendisjet e mahnitëshme e virtuoze, me fije mëndafshi ose ari të mjeshtrave qendistarë të disa qyteteve, dhe më herët, edhe pranë manastireve të kohës.

Në këtë studim kemi mbledhur disa oja nga fshatrat Zhitoshë, Cërnilishtë, Presill e ndonjë vjetër. Janë mjaft me interes edhe emërtimet dialektore të llojeve të ojave, që e bënë punimin mjaft me interes. Këtë mund ta vërejmë në tekstilet e leshta të rajonit të Prilepit dhe Krushevës, të cilët shquhen për teknikën unike, ashtu siç janë të veçanta edhe thurjet me shtiza, ojat, dantelat, qendisjet e shumëllojshme. Veshjet popullore edhe pse nuk janë ruajtur komplet, shamitë me oja janë ruajtur mirë dhe manifestojnë kulturën tradicionale të zonës dhe janë trashëguese e transmetuese të shumë elementeve që vijnë nga lashtësia. Janë karakteristike dhe të lashta, motivet popullore që përdoren në disa oja dhe qendisje të tjera, me kombinime shumëngjyrëshe me shije të hollë artistike.

Mund të konkludojmë se artizanatet janë formë e vjetër e shprehjes artistike të folklorit tradicional shqiptar. Nga prodhimet e artizanatit, punët e dorës së grave janë shumë të lashta si traditë dhe janë ato që më së shumti i kanë rezistuar kohës deri në ditët e sotme. Vend të rëndësishëm në punët e dorës së grave zë përgatitja e kostumeve popullore, punimet me filigran, endja e pëlhurave të ndryshme, thurjet me shtiza, ojat e dantelat dhe qendisjet e shumëllojshme. Ato janë ruajtur në mënyrë origjinale dhe janë një shprehje e qartë e identitetit shqiptar”.

Ojat

Oja me shtizë



Oja me xhilpan



Oja me Filqet



**Oja me kik**



**Oja badre**



Informatori:

Kadrie Izeri e lindur në vitin 1945 në fsh Nerovë profesioni Amvise

Barie Saliu e lindur në vitin 1953 në fsh Zhitoshe profesioni Amvise







### Qëndisja

Kanë qëndisur jastëk, kanë qëndisur qoshnike, perde të qindisme, çarçaf, çevre kur e japin vajzën i çon dhondrrit, urteja për te jastëku, këmisha të qinejsme, dikollta e qinejsme, peshterka te qinejsme en e zezë en e bardhë.



Llojet e ojave:

Oja shiritka me koke

Oja arxhailka

Oja badre

Oja bellushinka

Oja dhomguske

Oja dorë për dore

Oja filqetka

Oja Gostivarka

Oja kriske

Oja me ruza me nji shtiz

Oja nizamke

Oja shiritka me koke

Oja shutka

Oja trobozoni me koke

Informatore: Barije Saliu, 58 vjeçare, pa shkolë nga fshati: Zhitoshe

Mbledhesi: Axhije Saliu

Data:22.12.2020

## PËRFUDNIM

Tekstet e këngëve nga rajoni i Pelagonisë pasqyrojnë ngjarje dhe personazhe me rëndësi historike (siç është përmendja e emrit Skëndërbe në një këngë), por edhe marrëdhënie intime të njerëzve të thjeshtë të popullit. Zakonisht personazhet dalin me emrat e tyre të vërtetë, por ndodh shpesh që personazhet e këngëve fshihen pas emrave simbolikë, si: *Lulie*, *ashike* etj.

Në **pjesën hyrëse** janë dhënë vendbanimet me popullsi shqiptare të shpërndarë në dy rajone: rrethi i Prilepit (Dollnenit) dhe Krushevës. Të gjithë ata kanë qenë objekt studimi në këtë punim. Në territorin e komunës së Dollnenit, kemi gjurmuar material në 7 fshatra, edhe atë në: **Zhitoshë, Cërnilishtë, Desovë, Gostirazhni, Peshtalevë, Llazhan** dhe **Debresht**: Po aq, kemi përfshirë edhe në rrethin e Krushevës: **Borinë, Nerovë, Alldance, Jakrenovë, Sazhdevë, Presill** dhe **Bellushinë**. Më parë shqiptarë ka pasur edhe në fshatrat **Dërnovcë, Pribillcë, Novosellë, Zagoricë, Ivanovcë, dhe në Vërboec** ku sot nuk ka më asnjë shqiptar.

Personazhet e këngëve popullore të rajonit të Pelagonisë lëvizin, kryesisht në rajonin e vet, Shqipërinë e mesme, por nga një rast kemi edhe Shqipërinë e Veriut (Shkodër) dhe atë të Jugut. Por ndodh që të përmenden edhe emra gjeografikë të vendeve të Europës, Afrikës dhe Amerikës.

Fondi i këngëve popullore të rajonit të Pelagonisë, edhe pse në numër i vogël, është një thesar i pasur që shquhet për cilësinë e lartë të teksteve. Me keqardhje mund të konstatojmë, se ky fond, nuk është mbledhur në tërësi dhe shumë pak është botuar.

Si shtesë e të gjitha sa përmenda më sipër dua të shtoj se kënga e dasmës pellagonase, për aq kohë sa ishte gjallë, gjithnjë ka ndryshuar dhe është pasuruar me elemente të reja. E kam përmendur edhe më sipër se kushtet dhe mundësitë ndryshuan në drejtimin e kryerjes së ritit të dasmës edhe në Pelagoni si kudo. Diku ndryshuan për mirë e diku ndryshuan edhe për më keq si pasojë e varfërisë së përgjithshme në të gjitha kuptimet dhe nocionet e kësaj fjale. Në këngë filluan të zëvendësoheshin mjaft emërtime e të futeshin mjaft të tjera si elemente të reja. Emra si “kali i shalës” u zëvendësua me “limuzinë” e mjaft të tjera, por u duken edhe fjalë të tjera si “ora”, “lule” e shumë të tjera që filluan të futen si elemente të reja që filluan të përdoreshin dhe që më përpara s’kishin qenë të traditës. Ora nuk ka qenë pjesë e nishanit apo të shenjtit dikurë, por as zbukurimet e kalit me lule, veç më vonë filluan të zbukurohen veturat që shkonin të merrnin nuset. Po të vihet re me kujdes përdorimi i fjalorit, mund të dallojmë qartë se cilat këngë kanë pësuar ndryshime dhe janë kënduar më vonë e cilat kanë qenë

kënduar më herët. Natyrisht, kur nusja kishte ardhur me vel e veshur në ditën e saj të martesës, nuk mund të përmendej më fjala dullak, bofçe apo shami, por fjala vel.

Nusja nuk i bënte më zullufet, por rregullohej e krihej në një mënyrë krejt të re dhe sipas traditës qytetare e moderne. Pra, nuses që ishte veshur me vel e kurorë dhe që flokët i kishte krehur në mënyrë moderne e me kaçurela, nuk mund t'i thuhej më “Moj nuse me zullufe”, pasi mund të dukej mjaft qesharake për atë që mund ta këndonte.

Tani me bindje mund të thuhet se një pjesë e folklorit të shqipes është përmbledhur, shtypur dhe studiohet më gjerësisht. Një gurë i vogël, që sadopak do të peshoje në studimet folklorike të gjuhës shqipe, do të jetë edhe kjo tezë e masterit të rrethit të Prilepit dhe Krushevës. Rrethina të cilët edhe pse gjenden në një hapësirë të izoluar nga folësit e tjerë shqiptarë në Maqedoni, asnjëherë nuk e kanë ndërprerë lidhjen me të folmet tjera shqipe, por me xhelozsi si të folme më periferike kanë sajuar inovime të veta të veçanta dhe kanë ruajtur me xhelozsi traditat dhe zakonet e dasmave dhe zhanret tjera folklorike.



## LITERATURA

- AGANI, Hilmi. Letërsia popullore (pjesa e parë), bot. IV, Prizren 1966.
- BIDO, Agim. Arti popullor në veshje e tekstil. Tiranë 1991.
- Folklor shqiptar I, Inst. i Folklorit. Tiranë 1966.
- IBRAHIMI, Mustafa. Atlasi dialektologjik i të folmeve shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Vëll I – *Blegtoria*. Interlingua, Shkup 2019.
- IBRAHIMI, Mustafa. Atlasi dialektologjik i të folmeve shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Vëll II – *Veglat tradicionale*. Interlingua, Shkup 2020.
- IBRAHIMI, Mustafa. Dita e verës dhe Shëngjergji në rajonin e Pelagonisë. ALB-KULT, Shkup 2019.
- IBRAHIMI, Mustafa. *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*. Interlingua, Shkup, 2005
- IBRAHIMI, Mustafa. *Fjalë dhe shprehje popullore nga rrethi i Prilepit, Krushevës dhe Velesit*. "Interlingua", Shkup 2007.
- IBRAHIMI, Mustafa. *Mikrotoponimet e vendbanimeve shqiptare në rrethin e Prilepit, Krushevës dhe Velesit*. Interlingua, Shkup 2010.
- IBRAHIMI, Mustafa. Proza gojore shqiptare në trevat e Prilepit dhe Krushevës. Interlingua, Shkup 2017.
- IBRAHIMI, Mustafa. *Thesari folklorik shqiptar nga rajoni i Pelagonisë, Flaka*, Shkup 2003.
- ISMAILI, Zejadin Mbi folklorin dhe llojet e tij. Idriz Seferi 2000.
- KROSI, Ibrahim. Lirika popullore shqiptare në Maqedoni. Shkup 2000.
- NEZIRI Zeqirja, Letërsia gojore shqiptare. Shkup 1997.
- SHALA, Demush, Letërsia popullore. Prishtinë 1985.
- TUDA, Rahmi. Larmia e disa formave dhe motiveve folklorike. Strugë 2000.
- TUDA, Rahmi. Vlerësime folklorike. Tetovë 1998.
- B e a d i n S h e r i f i, Këngë lirike prespane. Korçë 1993.
- B e a d i n S h e r i f i, Këngë nga Prespa. Shkup 1991.
- D e m u s h S h a l a, Letërsia popullore. Prishtinë 1985.
- F e h i m S e j f u l l a i - R e ç a n i, Këngë popullore të Gostivarit. Shkup 1989.
- Folklor shqiptar I, Inst. i Folklorit. Tiranë 1966.
- H a x h i h a s a n i, Qemal, Vëzhgime folklorike në Përmet, BUSHT, ser. e shkenc. shoq. 2/1959. Tiranë.

Hilmi Agani, Letërsia popullore (pjesa e parë), bot. IV, Prizren 1966.  
Ibrahim Krosi, Këngë popullore lirike nga Derveni. Shkup 1964.  
Ibrahim Krosi, Lirika popullore shqiptare në Maqedoni. Shkup 2000.  
Mojsi Lutfiu, Lojëra popullore dibrane. Dibër 1997.  
Mumin Zeqiri, Nga lirika familjare shqiptare e Kumanovës. Kumanovë 1995.  
Nuhi Vinca, Lirika popullore shqiptare në regjionin e Strugës. 1992 Shkup.  
Zeqirja Neziri, Letërsia gojore shqiptare. Shkup 1997.

### **Burime të tjera**

GSND= Glasnik Skopskog Naucnog Drustva.

Enicereví VB = N. Enicereví, VípiminaniÔ i beleski, SofiÔ 1906.

Kíncov MES = V. Kíncov, MakedoniÔ, etnografiÔ i statistika. SofiÔ 1900.

Lzb = Literaturen zbor, Skopje

PP I = Prilep i Prilepsko niz iztorijata kn. I, Prilep 1971.

PP II = Prilep i Prilepsko niz istorijata kn II, Prilep 1972.

1961 = Naselenie po narodnost i nselbi vo SRM (spored administrativno - teritorijalna podelba od 9. II. 1962 god.) Zavod za statistika, Skopje 1964.

1971 = Naselenie po narodnost vo SRM - po opstini, gradovi i nselbi (spored administrativno - teritorijalna podelba od 01.I.1972 god.). Statisticki pregled 42, Skopje 1973 god.

1981 = Popis na naselenieto, domasinstvata i stanovite vo 1981. Nekoi podatoci za naselenieto, domasinstvata i stanovite po opstini i mesni zaednici - konecni podatoci, Statisticki pregled 131, Skopje 1983 god.

1991 = Popis na naselenieto, domakinstvata, stanovite i zemjodelskite stopanstva vo 1991 god., Skopje 1992.

Pop Deft. PN = Popisen defter na Prilepskata nahija, br.4 od 1467/8 i 1544/45 - filmovi vo arhivot na Makedonija.

Traicev GP = G. Traiceví, Gradí Prilçpí. SofiÔ 1925.

Haxi-Vas. PNO = J. Haxi-Vasiqeviq, Prilep i wegova okolina, Beograd 1902.

[aldeví GPEV= H. [aldeví, Gradí Prilçpí ví bílgarskoto vízra`dane (1838 -1878), SofiÔ 1916.

## **Deklaratë**

Unë, Mustafa Ibrahimimi profesor ordinar në Universitetin “Nëna Tereza,, - Shkup, deklaroj se e kam lektuar temën e magjistraturës së kandidatës Axhije Saliu me titull: “Folklori në rajonin e Prilepit dhe Krushevës” prej faqes 1 deri ne faqen 82 dhe për të njejtën mbaj përgjegjësi juridike dhe morale.

Prof. dr. Mustafa Ibrahimimi

---

Shkup, 2021